



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN E
MJEKËSISË LIGJORE”

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI
“PËRPUTHSHMËRI DHE RREGULLSHMËRI FINANCIARE”

		<i>Faqe</i>
I	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	2-5
II	HYRJA	6-8
a.	Qëllimi dhe Objektivat	6-6
b.	Identifikimi i çështjes	6-6
c.	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	6-7
d.	Përgjegjësitë e audituesve	7-7
e.	Kriteret e vlerësimit	7-8
f.	Standardet e auditimit	8-8
III	PËRSHKRIMI I AUDITIMIT	8-9
IV	GJETJET DHE REKOMANDIMET	9-33
	Drejtimi 1: <i>Përputhshmëria ligjore për marrëdhëniet e punës dhe të pagave, realizimi i fondit të pagave, shpërblimeve, sigurimeve shoqërore e të tjera personeli:</i>	9-11
	Drejtimi 2: <i>Prokurimet e fondeve publike për mallra, punë dhe shërbime:</i>	12-32
	Drejtimi 3: <i>Mbi zbatimin e procedurave dhe vlerësimi i auditimit të kryer nga struktura e Auditimit të Brendshëm e Ministrisë së Drejtësisë në IML.</i>	32-33
V	KONKLUZIONE DHE OPINIONI I AUDITIMIT	33-38
VI	ANEKSE	39-40



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN E
MJEKËSISË LIGJORE”

I- PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

a. Një përshkrim i shkurtër i auditimit

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Kontrolli i Lartë i Shtetit auditoi “Institutin e Mjekësisë Ligjore”, më poshtë e emërtuar IML, për periudhën 01.01.2018 deri më 30.10.2019 me objekt “Auditim përputhshmërie dhe rregullshmërie financiare” Auditimi u orientua në tre drejtime kryesore të përcaktuara në programin e auditimit. Në këtë auditim u angazhuan 5 (pesë) auditues të Kontrollit të Lartë të Shtetit. Konkluzionet përkatëse paraqiten në mënyrë më të hollësishme në pjesën e IV dhe V, të këtij Raporti Përfundimtar dhe konsistojnë kryesisht në;

-Nga auditimi mbi veprimtarinë e IML u konstatuan mangësi dhe të meta në disa nga fushat e audituara ku përmendim: Nga titullari i AK, për periudhën 01.01.2019 deri në 30.10.2019, nuk është caktuar personi përgjegjës për prokurimin, kjo në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014. Staf i përgjegjës për zhvillimin e procedurave të prokurimit nuk disponon trajnimet e nevojshme për pasojë janë evidentuar paqartësi në hartimin e kriterëve të veçanta për kualifikim dhe specifikimeve teknike. Nëpunësi Zbatues, është aktivizuar në disa struktura të prokurimeve publike (në hartimin e fondit limit; në njësinë e prokurimit dhe në ekzekutimin e kontratës), veprime të cilat bien ndesh me dispozitat ligjore në fuqi. Në të gjitha praktikat e blerjeve me vlerë të vogël përgjatë vitit 2019 përlllogaritja e fondit limit është bërë bazuar çmimeve të blerjeve të vitit 2018, bazuar në tabelën përkatëse të pa firmosur nga komisioni i blerjeve të vogla, mungojnë specifikimet teknike dhe kriteret e kualifikimit, për çdo rast fondi limit është llogaritur para daljes së urdhër prokurimit etj. Institucioni ende rezulton me problematikë të pazgjidhur mbi caktimin e Titullarit si Nëpunës Autorizues, etj.

Në përfundim të procedurës audituese, akt-konstatimit, Projekt Raportit të mbajtur, observacioneve të paraqitura, u rekomanduan masat përkatëse për përmirësimin e situatës.

I.b. Një përmbledhje e gjetjeve kryesore dhe rekomandimet përkatëse paraqitet sa më poshtë:

NR.	PËRMBLEDHJE E GJETJES	REFERENCA ME RAPORTIN PËRFUNDIMTAR	RËNDË SIA	REKOMANDIMI
1.	-Nga auditimi i të gjitha objekteve tenderuese kryesisht për mallra/punë (për shkak të specifikës së detyrës funksionale të institucionit të IML, konkretisht procedurat me objekt; -“Blerje reagentësh dhe materiale laboratorike” me fond limit 12,508,333 lekë pa tvsh; -“Blerje pajisje për autopsinë”, me fond limit 4,183,333 lekë pa tvsh -“Rikonstruksioni i çatisë dhe ambjenteve të brendshme IML”, me fond limit 4,099,712 lekë pa tvsh Rezultoi se, IML si Autoritet Kontraktor, ka numër të kufizuar të administratës me burime njerëzore, për shkak të strukturës me numër të vogël, të cilët rezultuan të pa trajnuar në mënyrë periodike pranë Agjencisë së Prokurimeve Publike (APP), për pasojë janë evidentuar paqartësi në hartimin e kriterëve të veçanta për	Drejtimi nr. 2 <i>“Prokurimet e fondeve publike për mallra, punë dhe shërbime:”</i> <i>Trajtuar më hollësisht në faqet nr 12-32 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.</i>	E mesme	- Nga Autoriteti Kontraktor i Institutit të Mjekësisë Ligjore, të merren masa, për të analizuar me kujdes të gjitha veprimet nga struktura prokuruese, për vendosjen e kriterëve dhe kërkesave kualifikuese, sa më të qarta dhe jodiskrimuese, për të mundësuar përfshirjen në garë të një numri sa më të madh ofertuesish dhe garantimin e efektivitetit, efikasitetit dhe ekonomicitetit të fondeve publike. - Instituti i Mjekësisë Ligjore, në bashkëpunim me APP, e cila në mënyrë të vazhdueshme bashkëpunon me Shkollën



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN E
MJEKËSISË LIGJORE”

	<p>kualifikim dhe specifikimeve teknike (në këto struktura janë angazhuar mjekë specialist të fushës), të cilët duhet t'i paraqesnin vendosjen e tyre në mënyrë të hollësishme duke e argumentuar, duke mbajtur një procesverbal, në mbështetje të ligjit nr.9646 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”i ndryshuar, neni 27 (kontrata e mallrave), neni 26 (kontrata pune) neni 61 (hartimi dhe publikimi i dokumentave të tenderit). -Nga auditimi u kontaktua se, nga titullari i AK, për periudhën 01.01.2019 deri në 30.10.2019, nuk është caktuar personi përgjegjës për prokurimin, kjo në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”i ndryshuar, neni 57, i ndryshuar me VKM nr.797, datë 29.12.2017 “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr.914, datë datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik.” -Gjithashtu, rezultoi se, Nëpunësi Zbatues, është aktivizuar në disa struktura të prokurimeve publike (në hartimin e fondit limit; në njësinë e prokurimit dhe në ekzekutimin e kontratës), veprime të cilat bien ndesh me ligjin nr.9646 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”i ndryshuar, ligjit nr.9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe ligji nr.10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar.</p>			<p>Shqiptare të Administratës Publike për organizimin e trajnimeve për punonjësit e institucioneve qendrore të angazhuar me procedurat e prokurimit publik, të realizoj trajnimet e nevojshme për punonjësit e saj, me qëllim forcimin e kapacitetit administrative në këtë fushë.</p>
2.	<p>Nga auditimi me zgjedhje i procedurave të prokurimit për periudhën Janar-Tetor 2019, rezultoi se, në një numër të kosiderueshëm rastesh, nga njësia e prokurimit nuk janë respektuar përcaktimet e bëra në kuadrin ligjor të prokurimeve publike, kryesisht të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, konkretisht në administrimin e dokumentacionit të përcaktuar që duhet të ketë një procedurë prokurimi, mungesën e llogaritjes së fondit limit, etj. Konstatohet se në të gjitha procedurat nuk administrohet proces-verbali për llogaritjen e fondit limit. Në të gjitha praktikat e blerjeve me vlerë të vogël përgjatë vitit 2019 për llogaritja e fondit limit është bërë bazuar çmimeve të blerjeve të vitit 2018, bazuar në tabelën përkatëse të pa firmosur nga komisioni i blerjeve të vogla për vitin 2018. Mungojnë specifikimet teknike dhe kriteret e kualifikimit rast pas rasti në</p>	<p>Drejtimi nr. 2 <i>“Prokurimet e fondeve publike për mallra, punë dhe shërbime:”</i></p> <p><i>Trajtuar më hollësisht në faqet nr 12-32 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.</i></p>	E mesme	<p>- Nga Instituti i Mjekësisë Ligjore, të merren masat e nevojshme administrative për mirëfunksionimin e procedurave të prokurimit publik, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi. Nga ana e Sektorit të Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse të institucionit të mos kryhet asnjë pagesë e pashoqëruar me dokumentacionin përkatës.</p>



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN E MJEKËSISË LIGJORE”

	<p>kundërshtim me përcaktimet e bëra në nenin 23 të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, pikën 5/a-c të nenit 27, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar. Në prokurimet me vlerë të vogël është llogaritur për cdo rast fondi limit para daljes së urdhër prokurimit, por pasqyrat e llogaritjes nuk janë administruar në dokumentacionin prokurues. Për mallrat e prokuruar me blerje të vogla nuk është përpiluar procesverbali i marrjes në dorëzim para hyrjes në magazinë.</p> <p>Gjithashtu në dosjet përkatëse të audituara u evidentuan mangësi në dokumentacion si, mungesë e Deklaratave të Konfliktit të Interesit të firmosura nga anëtarët e KVO, e faturave të akomodimit në hotel dhe gjithashtu shkresave mbi aktivitetin që do ka qenë i pranishëm përfaqësuesi nga Instituti i Mjekësisë Ligjore, etj.</p>			
3.	<p>Nga auditimi në Institutin e Mjekësisë Ligjore, rezultoi se, <u>në cilësinë e Nëpunësit Autorizues (NA), nuk është drejtuesi i institucionit z.B.X,</u> por zj.V.S me detyrë përgjegjës sektori në sektorin e menaxhimit të akteve dhe laboratorit, sipas shkresave të Ministrisë së Drejtësisë nr.5083 prot, datë 22.09.2017 dhe nga Ministria e Financave nr.12396/1 prot datë 19.09.2017 me lëndë “<u>Mbi caktimin e Nëpunësit Autorizues të Përkohshëm për IML</u>” sipas rrethanave faktike dhe juridike, si më poshtë vijon:</p> <p>-Instituti i Mjekësisë Ligjore, është institucion në varësi të Ministrit të Drejtësisë, i cili me fillimin e efekteve juridike të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, është përfshirë në skemën e administrimit të shërbimit civil.</p> <p>-Nga auditimi, u konstatua se, <u>B.X</u> gëzon statusin e nëpunësit civil, pasi ka filluar marrëdhënien e punës në këtë institucion, me aktin administrative nr.5762/1 datë 26.11.2013, të ministrit , në pozicionin “<u>Drejtor i Institutit të Mjekësisë ligjore</u>” të cilin e ka mbajtur deri më datë 20.06.2017, deri në daljen e aktit administrative nga ish-Ministri i Drejtësisë me shkresë nr.4052/3 datë 20.06.2017 “<u>Njoftim mbi fillimin e ecurisë disiplinore</u>” e shoqëruar me vendimin përfundimtar nr.4052/8 datë 28.06.2017 “<u>Për marrjen e masës disiplinore “largim nga shërbimi civil” për z.B.X.</u>”</p> <p>Për sa më sipër, Z.X e ka ankimuar këtë vendim, <u>duke rifituar vendin e punës dhe rikthimi në detyrë në bazë të vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë</u> nr.3462 datë 13.09.2017, me ekzekutim të përkohshëm, ka marrë formë të prerë, deri në momentin e vendimit të Gjykatës së Apelit</p>	<p>Drejtimi nr. 2 <i>“Prokurimet e fondeve publike për mallra, punë dhe shërbime:”</i></p> <p><i>Trajtuar më hollësisht në faqet nr12-32 të Raportit Përfundimtar të Auditimit</i></p>	E lartë	<p>- Nga Ministria e Drejtësisë, në bashkëpunim me Departamentin e Administratës Publike dhe Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë të merren masa për emërimin dhe realizimin e ndryshimit të Nëpunësit Autorizues të Përkohshëm, referuar shkresës së IML me nr. 1616 prot, datë 21.09.2018 dhe nr. 1855 prot, datë 09.03.2019, me të cilat është kërkuar ndryshimi respektiv, për caktimin e titullarit të institucionit z. B.X në pozicionin e nëpunësit autorizues.</p>



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN E MJEKËSISË LIGJORE”

<p>Administrative (është në process ankimimi nga MD).</p> <p>-Momentalisht, këtë detyrë e ushtron zj.V.S me detyrë <i>përgjegjës sektori në sektorin e menaxhimit të akteve dhe laboratorit</i>, në bazë të shkresave të sipër cituara.</p> <p>-Në bazë të “Rregullores për organizimin dhe funksionimin e Institutit të Mjekësisë Ligjore” neni 60, janë të përcaktuara detyrimet ligjore të pozicionit të Drejtorit të IML.</p> <p>Nga auditimi vlerësohet se, qartësisht disa prej funksioneve të Drejtorit të IML, kufizohen për shkak-pasojë të mospasjes së cilësisë së pozicionit të Nëpunësit Autorizues (NA), kjo në kundërshtim të ligjit nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 19, ligji nr.10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, neni 12, për rrjedhojë dhe ushtrimin e kompetencave në fushën e prokurimeve publike në zbatim të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 56 i tij.</p> <p><u>Evidentohet</u>, vonesë e zgjatur në lidhje me miratimin e nëpunësit autorizues (NA) nga Ministria e Drejtësisë në koordinim me Ministrinë e Financave, pasi sipas situatës së mësipërme ky vendim është marrë i mirëqënë dhe si rrjedhojë me ardhjen në detyrë të z.B.X (Drejtor IML) duhet që t’i kalonin dhe detyrat e NA që janë të përcaktuara në bazë të ligjit nr.9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar neni 19, ligji nr.10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar neni 12, për rrjedhojë dhe ushtrimin e kompetencave në fushën e prokurimeve publike në zbatim të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 56 (titullari i autoritetit kontraktor ose zyrtari i autorizuar).</p> <p>Gjithashtu, nga auditimi paralel në Ministrinë e Drejtësisë rezulton se, prej saj nuk është bërë ende kërkesë pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për ndryshimin e Nëpunësit Autorizues të Përkohshëm, ndonëse nga IML me shkresat nr.1616 prot datë 21.09.2018 dhe nr.1855 prot, datë 09.03.2019, është kërkuar ndryshimi respektiv për caktimin e titullarit të institucionit në pozicionin e nëpunësit autorizues.</p>			
--	--	--	--



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN E MJEKËSISË LIGJORE”

II- HYRJA

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Mbi Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Kontrolli i Lartë i Shtetit auditoi “Institutin e Mjekësisë Ligjore”, më poshtë e emërtuar “IML”, në bazë të programit të auditimit tematik të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit me nr. 813/1 prot. datë 18.10.2019, për periudhën e auditimit nga data 01.01.2019 deri më 30.10.2019, me afat auditimi nga data 18.10.2019 deri më 25.11.2019, dhe lloj auditimi “Auditim Përputhshmërie dhe Rregullshmërie Financiare” i cili u krye nga grupi i auditimit me përbërje:

1. K.X (Përgjegjës grupi)
2. V.G
3. H.K
4. B.K
5. A.K

Qëllimi i auditimit:

Qëllimi i auditimit është, dhënia e një vlerësimi objektiv, profesional, e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve mbi të cilat është rënë dakord, mbi bazën e te cilave ushtron veprimtarinë “Instituti i Mjekësisë Ligjore”. Vlerësimin e përputhshmërisë së veprimeve procedurale e administrative, të kryera me kriteret dhe kërkesat e legjislacionit. Evidentimi i shkeljeve të parimeve të ligjshmërisë dhe menaxhimit të shëndoshë financiar, shfrytëzimin me efikasitet, efektivitet dhe ekonomikitet të pasurisë shtetërore dhe fondeve publike, si dhe dhënia e rekomandimeve përkatëse për përmirësimin e gjendjes në vijim. Raportimin e të gjitha çështjeve të tjera që dalin apo lidhen me auditimin, të cilat Kontrolli i Lartë i Shtetit i konsideron të rëndësishme për t’u bërë publike.

Objektivat e auditimit:

Objektivi i auditimit është vlerësimi, mbi besueshmërinë e sistemeve të ngritura, procedurave të ndjekura nga “Instituti i Mjekësisë Ligjore”, gjatë realizimit të objektivave në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi. Përgjegjësia e drejtuesve të njësisë në mirëmenaxhimin e fondeve publike, duke garantuar parimet e transparencës, profesionalizmit, përgjegjshmërisë dhe sjelljes së zyrtarëve të sektorit publik.

Identifikimi i çështjes:

Fushëveprimi i këtij auditimi është vlerësimi me siguri të arsyeshme i veprimtarisë së “Institutit të Mjekësisë Ligjore”, për periudhën objekt auditimi nga 01.01.2019 deri më 30.10.2019, në përputhje me aktet ligjore të cilat rregullojnë veprimtarinë e këtij institucioni dhe konkretisht:

Masat e marra nga ana e Institucionit për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm, veprimeve financiare të kryera gjatë kësaj periudhe, marrëdhëniet e punës dhe realizimin e shpenzimeve lidhur me to, zbatimin e legjislacionit mbi realizimin e procedurave të prokurimit publik dhe marrjen në dorëzim të mallrave dhe shërbimeve, funksionaliteti i sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe njësisë së auditimit të brendshëm, si dhe çështje të tjera të cilat lidhen me aktivitetin në tërësi.

Përgjegjësia e Drejtimit për Përputhshmërinë me legjislacionin në fuqi:

Është detyrimi i menaxherëve të njësisë, që, në kryerjen e veprimtarive, të respektojnë parimet e menaxhimit të shëndoshë financiar, të ligjshmërisë e të transparencës në



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN E MJEKËSISË LIGJORE”

administrim, si dhe të përgjigjen për veprimet e tyre dhe rezultatet që burojnë prej tyre përpara organit që i ka emëruar ata ose të cilëve u ka deleguar përgjegjësinë sipas përcaktimeve në Ligjin Nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar.

-*Nëpunësi autorizues* është përgjegjës për veprimet dhe vendimet e nxjerra gjatë veprimtarisë funksionale.

-*Nëpunës zbatues*, i caktuar si është personi përgjegjës sipas kuadrit normativ të zbatueshëm të raportimit financiar në sektorin publik dhe për mirëfunksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, i cili garanton përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të treguesve financiarë.

Përgjegjësia e Audituesit të KLSH për auditimin e Përputhshmërisë dhe rregullshmërisë

Përgjegjësia jonë (*Audituesit e KLSH-së*) është që nëpërmjet auditimit të realizuar:

-Të vlerësojë nëse, informacionet mbi çështjet në të gjitha aspektet materiale janë në përputhje me kriteret e përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi, masa e ndjekjes nga subjekti i audituar i rregullave, legjislacionit dhe akteve normative, politikave, kodeve të miratuara apo kushtet e përcaktuara (*ISSAI 4000*), nuk paraqesin devijime materiale nga kriteret e vlerësimit, si pasaktësi apo gabime dhe janë në përputhje me kuadrin rregullator mbi bazën e të cilit e ushtrohet veprimtaria e subjektit të audituar. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (INTOSAI), bazuar në këto standarde në aplikojmë gjykimin dhe skepticismin tonë profesional në punën audituese:

-Të kryejë në mënyrë efektive auditimin. (*ISSAI 1300*)

-Të vlerësojë nëse është siguruar evidenca e mjaftueshme dhe e përshtatshme e auditimit dhe nëse bazuar në këtë evidence ai mund të formojë konkluzionet përkatëse. (*ISSAI 1500/ISA 300*)

-Të kryejë procedura të përshtatshme auditimi në funksion të këtij objektivi.

Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në ISSAI-n 10 “Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t”, si dhe ISSAI 30 “Kodi Etik”, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura. Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e mara gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të vlerësuar përputhshmërinë e aktivitetit. Objektivat e punës sonë lidhen me garantimin e sigurisë së arsyeshme nëse çështjet subjekt auditimi, që mund të kenë ekzistuar, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë në veprimtarinë e subjektit të audituar.

Dokumentimi i rezultateve të auditimit:

Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit, i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën, dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore. Në përfundim të auditimit, mbi bazën e evidencave të marra dhe akt-konstatimeve të mbajtur, Projektraportit dhe observacioneve të paraqitura u përgatit raporti Përfundimtar i Auditimit.

Kriteret e vlerësimit:

-Ligji nr.8678, datë 14.5.2001 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Ministrisë së Drejtësisë”, i ndryshuar,

-Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar,

-Ligji nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar,

-Ligji nr. 114/2015 datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”,

-Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN E MJEKËSISË LIGJORE”

-VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar,
-Akte të tjera ligjore dhe nënligjore të detyrueshëm për zbatim.

Standardet e Auditimit

Auditimi u bazua në:

-Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë, Rregulloren “Për Procedurat e Auditimit” miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së Nr. 107 datë 08.09.2017, i ndryshuar, referenca të tjera ligjore dhe në kërkesat e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit si:

-Manuali i Auditimit të Përputhshmërisë. Referencë në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI) të INTOSAI-t dhe Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të Kontabilistëve IFAC.

Materialiteti dhe metodologjia e bazuar në risk

Kontrolli i Lartë i Shtetit konsideron një nivel sasior materialiteti deri në 2% në nivel grupi dhe llogarie. Në disa raste, gabimi edhe pse jo material nga ana sasiore, mund të shfaqet material nga **ana cilësore** “Një çështje ose grup çështjesh mund të jenë materiale ose për shkak të sasisë, natyrës (karakteristikave të brendshme) ose në varësi të kontekstit të tyre” për vet impaktin real por dhe ndjeshmërinë publike që ka veprimtaria e institucionit. Çështjet që janë materiale nga natyra ose përmbajtja duhet të zbulohen; ato do të lidhen me përputhmërinë e veprimtarisë së institucionit, duke u përfshirë kështu në konkluzionet e auditimit. Megjithatë, mbetet në gjykimin e KLSH-së, që çështje të veçanta në varësi të rëndësisë dhe impaktit të tyre, të merren në konsideratë në raportin e auditimit.

Praktikat e ndjekura në kryerjen e auditimit

Metodat dhe teknikat e kontrollit të përdorura nga audituesit gjatë auditimit u bazuan kryesisht në metodologjinë e aplikuar gjatë fazës së planifikimit;

-*Raporte dhe informacione* nga shfrytëzimi i raporteve/ informacioneve që lidhen direkt me objektivat e auditimit të marra në formë elektronike dhe shkresore.

-*Intervistimi i personelit* që ka patur role specifike.

Objektivi i audituesve ishte identifikimi dhe vlerësimi i risqeve e anomalive materiale në nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit e njësisë dhe mjedisit të saj, duke përfshirë kontrollin e brendshëm të njësisë dhe duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara drejt anomalive materiale.

III- PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

Instituti i Mjekësisë Ligjore (IML) është institucion qendror, buxhetor, në vartësi të Ministrit të Drejtësisë, krijuar me vendimin nr.120, datë 27.2.2003 të Këshillit të Ministrave, në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13 pika 1 dhe 19 pika 1 të ligjit nr. 7893, datë 22.12.1994 “Për zhvillimin e shkencës dhe teknologjisë” dhe të nenit 6 të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë.

Aktiviteti kryesor i IML bazohet në administrimin e tërësisë së njohurive dhe metodave aplikative mjekësore tekniko-shkencore në shërbim të praktikës së organeve të drejtësisë për zgjidhjen e çështjeve hetimore-gjyqësore me karakter mjekësor dhe biologjik, në veprimtarinë kriminale e konflikteve civile. Në të njëjtën kohë, përdorimi i të dhënave e ekspertimit



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN E MJEKËSISË LIGJORE”

mjekoligjor në dobi të forcimit të disiplinës tekniko-shkencore, të përmirësimit të cilësisë së punës diagnostikuese-mjekësore, të luftës parandaluese kundër pakujdesive e gabimeve mjekësore si dhe në studimin e shkaqeve të traumave, të helmimeve, të vdekjeve të papritura etj.

Drejtimet e përgjithshme të veprimtarisë të këtij institucioni referuar VKM nr.120, datë 27.2.2003 “Për krijimin e Institutit të Mjekësisë Ligjore” dhe Rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e institutit të mjekësisë ligjore” miratuar me Urdhërin e Ministrit të Drejtësisë Nr. 6745, datë 04.11.2003, e ndryshuar, janë:

- a) Veprimtaria kërkimore-shkencore për zbulimin dhe zbatimin e metodave bashkëkohore në fushën e mjekësisë ligjore.
- b) Organizimi dhe drejtimi i veprimtarisë së shërbimeve të ekspertimit mjekoligjor në Republikën e Shqipërisë.
- c) Kryerja e ekspertimeve mjekoligjore, patologjike, toksikologjike, biologjike dhe psikiatrike, si dhe e veprimeve të tjera, sipas rasteve dhe procedurave të parashikuara në Kodin e Procedurës Civile, Kodin e Procedurës Penale dhe në ligje të veçanta.
- ç) Bashkërendimi i veprimtarisë së këtij Instituti me institucionet shëndetësore për parandalimin e veprave penale, që rrezikojnë jetën dhe shëndetin e pacientëve.
- d) Përgatitja dhe kualifikimi i vazhdueshëm shkencor i specialistëve të mjekësisë ligjore.
- e) Bashkërendimi i veprimtarisë me Institucionet homologe ndërkombëtare.

IV- GJETJET DHE REKOMANDIMET

➤ Drejtimi 1: Përputhshmëria ligjore për marrëdhëniet e punës dhe të pagave, realizimi i fondit të pagave, shpërblimeve, sigurimeve shoqërore e të tjera personeli:

Me urdhrin e Kryeministrit nr. 21 date 25.01.2014 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së IML” është dërguar struktura e IML sipas skemës 1 që i bashkëlidhet këtij urdhëri dhe është pjesë përbërëse e tij Organika e IML e cila rezulton të jetë sipas skemës nr. 2 që i bashkëlidhet këtij urdhëri dhe është pjesë përbërëse e tij. Në zbatim të këtij urdhëri i punonjësve të IML – së është planifikuar të jetë 30 punonjës. Sipas këtij urdhëri organika e IML është organizuar si më poshtë:

Drejtori IML

-Drejtor i Institutit të Mjekësisë Ligjore, **1 punonjës,**

Spektori i Ekspertizës Ligjore është i përbërë nga 19 punonjës gjithësej, nga të cilët

- Ekspert mjekoligjorë, **3 punonjës,**
- Ekspert antropolog ligjorë, **1 punonjës,**
- Ekspert mjekoligjorë të IML dhe pranë Gjykatave të Apelit, **9 punonjës,**
- Ekspert psikiatër ligjorë, **2 punonjës,**
- Ekspert toksikolog ligjorë, **3 punonjës,**
- Ekspert biologo ligjorë, **1 punonjës,**

Spektori I Menaxhimit të Akteve të Ekspertimit dhe Laboratorit, gjithësej 5 punonjës

- Përgjegjës sektori, **1 punonjës**
- Specialist, për menaxhimin e akteve të ekspertimit , **2 punonjës**
- Specialist, **1 punonjës**



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN E MJEKËSISË LIGJORE”

-Laborant, 1 punonjës

Spektori i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, 5 punonjës gjithsej, nga të cilët

-Përgjegjës Spektori, 1 punonjës

-Specialist Financë Buxheti, 1 punonjës

-Specialist Arkiv Protokoll, 1 punonjës

-Pastrues, 1 punonjës

-Shofer, 1 punonjës

Struktura e mësipërme është ndryshuar me Urdhërin e Kryeministrit nr. 74 datë 21.04.2016 “Për një ndryshim në Urdhërin nr. 21 datë 25001.2014 të Kryeministrit për miratimin e strukturës dhe organikës së IML-së”.

Nga Auditimi deri në 31.10.2019 rezultoi se struktura është e plotësuar me punonjësit sipas strukturës përkatëse. Gjithashtu nga shfletimi me zgjedhje dhe verifikimi i disa dosjeve të personelit të IML nuk u konstatuan probleme apo anomali.

2. Respektimi i dispozitave ligjore për paga, shpërblime

Mbështetur në ligjin nr. 8487 datë 13.05.1999 “Për kompetencat dhe caktimin e pagave të punës të ndryshuar” si dhe VKM-së nr. 717 datë 23.06.2009, “Për pagat e punonjësve mbështetës të Institucioneve buxhetore dhe nëpunësve të disa institucioneve buxhetore” i ndryshuar me VKM nr. 202 date 15.03.2017 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 717 datë 23.06.2009 të KM (për pagat e punonjësve mbështetës të Institucioneve buxhetore dhe të nëpunësve të disa institucioneve buxhetore të ndryshuar)”.

Nga Auditimi i vendeve të përcaktuara në strukturën organizative të dërguara me vendimin e mësipërm me pagat përkatëse rezultoi se pagat e përcaktuara në listë-pagesa, janë në përputhje me VKM për strukturën organizative dhe VKM nr.717 datë 23.06.2009 të ndryshuar.

Nga auditimi në tërësi të list-pagesave për periudhën e përcaktuar në program, rezultoj se shumica e përgjithshme e pagave sipas list-pagesave është e njëjtë me urdhër xhirimin e përgatitur për këtë qëllim. Urdhër xhirimet janë të firmosura nga urdhër xhiruesi i institucionit dhe Kontantabilisti i IML-së. Në listë-pagesat e hartuara dhe miratuara për këtë qëllim, janë hartuar mbi bazën e nivelit të pagës të përcaktuara në VKM e më sipërme për pagat, vjetërsisë në punë duke kryer përlllogaritjet mbi tatimin për të ardhurat nga punësimi dhe kontributet shoqërore dhe shëndetësore.

Janë kryer ndalesat për tatimin e të ardhurave personale nga punësimi sipas përcaktimeve në përputhje me Udhëzimin e MF nr. 5 datë 30.01.2006 për tatimin mbi të ardhurat i ndryshuar.

Janë përlllogaritur, ndaluar dhe derdhur në organet tatimore kontributi i sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore mbi bazën e pagës përkatëse dhe përqindjeve përkatëse punëdhënës dhe punëmarrës në zbatim të VKM nr. 1114 datë 30.07.20118 i ndryshuar “Për disa çështje më zbatim të ligjeve nr.7003 datë 11.05.1993 “për sigurimet shoqërore në republikën e Shqipërisë” i ndryshuar ; ligji nr. 9936 datë 19.09.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore ne Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar: si dhe udhëzimi i MF nr. 26 datë 16.04.2009 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve Shëndetësore dhe shoqërore” i ndryshuar dhe pas hyrjes në fuqi të



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN E
MJEKËSISË LIGJORE”

VKM 457 datë 09.07.2014 “Për disa ndryshime në VKM nr. 1114 datë 30.07.2008 “Për disa çështje në zbatim të ligjeve nr. 7003 datë 11.05.1993, për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar.

Realizimi i fondit të pagave (plan fakt dhe në përqindje për periudhën 10 mujore viti 2019

Nga verifikimi dhe analizimi i fondit të pagave per periudhën mujore janar-tetor 2019 i rishikuar konstatohet se:

Llogaritje(600) “Paga e shperblime” planifikuar 31.502 dhe realizuar faktik 26.274 me një deviacion 5.228 lekë ose **83.4 %**.

Llogaritje(601) “Kontribute Sigurime Shoqërore dhe shëndetësore”, planifikuar 4.915 dhe realizuar faktik 3.969 me një deviacion 946 lekë ose **80.7 %**.

Llogaritje(602) “Shpenzime operative, planifikuar 42.883 dhe realizuar faktik 35.679 me një deviacion 7.204 lekë ose **83.2 %**.

Në përfundim totali i shpenzimeve rezulton te jetë, 79.240 dhe realizuar faktik 65.922 me një deviacion 13.318 lekë ose **83.2 %**.

Realizimi i fondit të pagave për periudhën mujore janar – tetor viti 2019 paraqitet në pasqyrën financiare si më poshtë

Të dhënat në 000/lekë

Nr	Emërtimi	Periudha 01.01.2019		Periudha Janar-Tetor 2019 i rishikuar		Deviacioni janar - tetor	
		Plan	Fakt	Plan	Fakt	Lekë	%
1	Llog.(600) “Paga e shperblime”	33.000	2.607	31.502	26.274	5.228	83.4
2	Llog.(601) “Kontribute Sig.Shoq shende”	6.000	389	4.915	3.969	946	80.7
3	Llog.(602) “Shp.operative”	42.000	2.086	42.883	35.679	7.204	83.2
	Totali	81.000	5.082	79.240	65.922	13.318	83.2

Shënim: Të dhënat janë disponuar nga specialisti Financës së IML-së.

Të dhënat në 000/lekë

Periudha Janar-Shtator 2019	Llogarit e analizuara				Totali
	Llog. 600	Llog. 601	Llog. 602	Llog.606	
Programimi	33.000	6.000	42.000		81.000
Shtesa të alokuara				200	200
Totali 2019	33.000	6.000	42.000	200	81.200
Celja nga Buxheti	33.000	6.000	42.000	200	81200
Realizimi i Shpenzimeve	26.274	3.969	35.679		65.922
Realizimi në %	80%	66%	85%	0%	

Shënim: Të dhënat janë disponuar nga specialisti Financës së IML-së.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN E MJEKËSISË LIGJORE”

➤ Drejtimi 2: Prokurimet e fondeve publike për mallra, punë dhe shërbime:

Gjatë auditimit, grupi i audituesve të KLSH-së, u fokusua në zbatimin e bazës ligjore dhe nënligjore ligji nr. 9646 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, VKM nr.918 datë 29.12.2014 “Për kryerjen e procedurave të prokurimit publik në mënyrë elektronike”, Udhëzim e APP-së nr. 2 datë 27.01.2015 “Për hartimin e regjistrit të parashikimeve të prokurimit publik dhe regjistrit të realizimeve të prokurimit publik”, ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të udhëzimit të Ministrit të Financave nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, si dhe çdo akti juridike që është në fuqi në lidhje mbi prokurimet publike të financuara nga Buxheti i Shtetit.

Në bazë të auditimit pranë institucionit të Institutit të Mjekësisë Ligjore, në cilësinë e Autoritetit Kontraktor, për periudhën 01.01.2019 deri në 30.10.2019, janë realizuar 4 (katër) procedura prokurimi, nga të cilat 1(një) procedurë e hapur dhe 3 (tre) procedura “kërkesë me propozim”, me vlerë të fondit limit prej 24,631,378 lekë pa tvsh ose në vlerë kontrate prej 23,032,625 lekë pa tvsh, të cilat janë audituar plotësisht.

Grupi i auditimit, është mbështetur në metodën e gjurmimit të dokumentacionit, në hartimin dhe njoftimin e regjistrit të prokurimit publik, në llogaritjen e fondit limit, në shpalljen e prokurimit; hartimi i kërkesave për kualifikim, në miratimin e dokumentave standarte të tenderit; në paraqitjen dhe shqyrtimin e ofertave; në vlerësimin e ofertave dhe klasifikimin e ofertuesve, në verifikimin në sistemin prokurimit elektronik (SPE); në menaxhimin e procesit të ankimit nga pjesëmarrësit në proces; në njoftimin dhe hartimin dhe nënshkrimin e kontratës me operatorin fitues dhe zbatimin e saj, ku çdo paqartësi është diskutuar me personat përgjegjës për procesin e prokurimit të audituar.

Në bazë të auditimit, janë verëjtur këto mangësi të përgjithshme, si vijon:

I. Nga auditimi i të gjitha objekteve tenderuese kryesisht për mallra/punë (për shkak të specifikës së detyrës funksionale të institucionit të IML, konkretisht procedurat me objekt:

“Blerje reagentësh dhe materiale laboratorike” me fond limit 12,508,333 lekë pa tvsh;

“Blerje pajisje për autopsinë”, me fond limit 4,183,333 lekë pa tvsh

“Rikonstruksioni i çatisë dhe ambjentëve të brendshme IML”, me fond limit 4,099,712 lekë pa tvsh

u konstatua se IML, si Autoritet Kontraktor, ka numër të kufizuar të administratës me burime njerëzore, për shkak të strukturës me numër të vogël, të cilët rezultuan të pa trajnuar në mënyrë periodike pranë Agjencisë së Prokurimeve Publike (APP), për pasojë janë evidentuar paqartësi në hartimin e kriterëve të veçanta për kualifikim dhe specifikimeve teknike (në këto struktura janë angazhuar mjekë specialist të fushës), të cilët duhet t’i paraqisnin vendosjen e tyre në mënyrë të hollësishme duke e argumentuar, duke mbajtur një procesverbal, në mbështetje të ligjit nr.9646 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 27(kontrata e mallrave), neni 26 (kontrata punë) neni 61 (hartimi dhe publikimi i dokumentave të tenderit).



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN E MJEKËSISË LIGJORE”

II. Nga auditimi, u konstatua se, Nëpunësi Zbatues (NZ) i ILM-së, z.A.M në cilësinë e NZ me detyrë me detyrë përgjegjës i sektorit të financës dhe shërbimeve mbështetëse, është njohur me shkresë nr. 3470/1 prot datë 18.03.2014 ,nga Ministria e Financave me objekt “njoftim për Nëpunësin Zbatues të Institutit të Mjekësisë Ligjore” ku citohet se “...Në zbatim të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, konfirmojmë Nëpunës Zbatues për Institutin e Mjekësisë Ligjore z. A.M, përgjegjës i financës dhe shërbimeve në IML.”

Për sa më sipër, nga auditimi, mbi këtë pozicion, u konstatuar se, NZ, është aktivizuar në disa struktura të prokurimeve publike (në hartimin e fondit limit; në njësinë e prokurimit dhe në ekzekutimin e kontratës), veprime të cilat bien ndesh me ligjin nr.9646 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”i ndryshuar, ligjit nr.9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe ligji nr.10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar.

III. Nga auditimi u konstatua se, nga titullari i AK, për periudhën 01.01.2019 deri në 30.10.2019, nuk është caktuar personi përgjegjës për prokurimin, kjo në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”i ndryshuar, neni 57, i ndryshuar me VKM nr.797, datë 29.12.2017 “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr.914, datë datë 29.12.2014 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik.”

Më poshtë po paraqesimin, ecurinë e auditimit dhe konstatimet:

1). Auditimi i procedurës me objekt “Blerje reagentësh dhe material laboratorike për vitin 2019” me fond limit 12,508,333 lekë pa tvsh.

Të dhënat e përgjithshme të tenderit

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : Blerje reagentësh dhe material laboratorike për vitin 2019		
1. Urdhër Prokurimi nr. 889 prot datë 16.04.2019	3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit nr.889 prot datë 16.04.2019	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër nr. 889/1 dt. 16.04.2019
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit “procedurë e hapur”	1.A.M 2.Z. I 3.S. B Hartuesi i fondit limit në bazë të urdhërit nr. 242 prot datë 31.01.2019; 1.A.M kryetar 2.E.S anëtar 3.M.K (Ç) anëtar	1.E. Sh kryetar 2.B.P anëtare 3.F.M anëtar
5.Fondi Limit (pa tvsh) 12,508,333 (dymbëdhjetë milion e pesëqind e tetë mijë e tridhjetë e tre) lekë.	6. Oferta fituese (pa tvsh) 12,461,210 (dymbëdhjetë milion e katërqind e gjashtëdhjetë e një mijë e dyqind e dhjetë) lekë	7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 47,123 lekë
8. Data e hapjes së tenderit	9.Burimi Financimit	10. Operatoret Ekonomike



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN E MJEKËSISË LIGJORE”

Data 06.06.2019, ora 10:30	Buxheti i Shtetit	a) Pjesëmarrës në tender 2 OE b) S'kualifikuar 1 OE
11. Ankimime 1. F...shpk Urdhër për pezullimin e oërkohshëm nr.1088, datë 13.05.2019 2. Rekomandime nga APP datë 17.05.2019	12. Përgjigje Ankesës nga AK 1. Urdhër për pezullimin e përkohshëm nr.1088, datë 13.05.2019 2. Kthim përgjigje F... nr.1143/1, datë 17.05.2019 3. Tërheqja e F.... shpk nga tenderimi datë 20.05.2019 4. Kthim përgjigje APP-së në datë 21.05.2019 5. Publikim Modifikimi datë 22.05.2019 6. Urdhër për vazhdimin e procedurës nr.1088/1, datë 22.05.2019	13. Përgjigje Ankesës nga KKP (nuk ka)
b. Zbatimi i Kontratës Blerje regentësh dhe materiale laboratorike		
14. Lidhja e kontratës Nr.1404 datë 21.06.2019, me afat prej 3 muajve	15. Vlera e kontratës (me tvsh) 14,953,452 (katëmbëdhjetë milion e nëntëqind pesëdhjetë e tre mijë e katërqind e pesëdhjetë e dy) leke me tvsh.	
16.	17. Urdher-shpenzime Nr. 157, datë 24.07.2019, Nr. 158, datë 24.07.2019, Nr. 162/1, datë 08.08.2019, Nr.163/1, datë 08.08.2019, Nr.177, datë 28.08.2019, Nr.178, datë 28.08.2019, Nr.199, datë 07.10.2019, Nr.200, datë 07.10.2019 dhe Nr.211, datë 22.10.2019	

a. Auditimi në lidhje mbi hartimin e dokumentave të tenderit, hartimin e e specifikimeve teknike:

Nga auditimi rezultoi, se njësia e prokurimit i ngritur në bazë të Urdhër prokurimi nr.889 prot datë 16.04.2019 me përbërje (A.M, Z.I dhe S.B) ka mbajtur procesverbalin e datës 06.05.2019, për hartimin dhe miratimin e dokumentave të tenderit nga Titullari i AK-së në cilësinë e nëpunësit autorizues, ku u konstatua se :

1. Në shtojcën 10 të DT në pikën 1 dhe 2 të specifikimeve teknike , AK ka kërkuar:

-Pika 1: “Artikujt e ofruar duhet të jenë me cilësi sipas standarteve për mjeksinë-ligjore.

-Pika 2: “reagentët duhet të plotësojnë standartin e pastërtisë :GR.AR.PH.EUR”.

Në lidhje me pikat e mësipërme, vihet re se AK nuk ka mirëpërcaktuar standartet të cilat duhet të plotësojnë artikujt që do të ofertohej nga OE, më konkretisht:

-Në pikën 1 të specifikimeve teknike, AK ka përcaktuar “...sipas standarteve për mjeksinë-ligjore” ndërkohë që duhet të përcaktonin standartet në mënyrë konkrete dhe shteruese, me qëllim hartimin e një kërkese të plotë dhe të saktë.

Pra, AK sipas VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 27 (Kontrata e mallrave) pika 3 që përcakton se “...Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

-Në pikën 3 të shtojcës 10 të DT, AK ka përcaktuar se “Artikujt me (nr.01,02,09,10,26,40,71,74,76,143,144,145) preferohen prodhim M..., në të kundërt ofertuesi duhet të paraqesi mostrat ekuivalente pranë laboratorit minimuni 2 orë para hapjes së ofertave për të provuar reagentët”.

Vendosja e kriterit bie ndesh me ligjin nr.9643, datë 21.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, neni 23/5 ku parashikohet se “Specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN E
MJEKËSISË LIGJORE”

kërkesë apo referencë të ndonjë markë apo emër i veçantë, patent vizatim ose tip, origjinë specifike prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme apo e kuptueshme e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët “ose ekuivalent” të përfshihen detyrisht në këto specifikime.”

Në pikën 2.3.4 të kapacitetit teknik, AK ka kërkuar “Operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e tij 2(dy) kimist me kohë të plotë. Për punonjësit me profesion si më sipër duhet të paraqesi: Diplomë; listë pagesat (E-Sig 025) të konfirmuara nga Administrata Tatimore për 6 muajt e fundit.”

Në lidhje me kriterin e mësipërm, njësia e prokurimit, duhet të kishte argumentuar teknikisht dhe ligjërish, nevojën e kërkesës së disponimit të 2 kimistëve me kohë të plotë, për sa kohë realizimi i kontratës në fjalë, konsiston **vetëm në blerjen e reagentëve dhe materialeve** nga autoriteti kontraktor përkatës, punonjësit e të cilit do të përdorin këto material.

Kështu, AK, duhej që në zbatim të VKM nr. 914, datë 29.12. 2014 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar , neni 61, çdo kriter i veçantë dhe specifikim teknik duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërish, si dhe të dokumentohet në një process-verbal.

Për sa më sipër, nga auditimi edhe pranë sistemit prokurimit elektronik të app.gov.al me REF-20564-05-06-2019, u konstatua se, nga njësia e prokurimit në vendosjen e kriterëve të veçanta, të cilat në mënyrë direkte ose indirekte, ka sjellë kufizimin e pjesëmarrjes së OE, ofertues të mundshëm, të cilët mund të disponojnë kapacitete të mjaftueshme për ekzekutimin e kontratës, e për rrjedhim vendosja e tyre duhej të kishte një argumentim të thelluar teknik dhe ligjor.

Nga auditimi, u konstatua se, në lidhje mbi vendosjen e kërkesave nga AK, është depozituar ankesë nga operatori ekonomik “F.....”shpk, ku me shkresë të Institutit të Mjekësisë Ligjore nr.1143/1 prot datë 17.05.2019 i është kthyer përgjigje për mos pranim të ankesës pasi nuk qëndron.

OE “F.....”shpk, më datë 20.05.2019, ka bërë me dije se shoqëria nuk është më e interesuar për këtë procedurë.

Gjithashtu dhe nga APP, në mënyrë eletronike të datës 17.05.2019, nga sektori i koordinimit të APP, i është rekomanduar për rishikim të disa prej kriterëve të të veçanta, të cilat nuk janë marrë në konsideratë nga AK, duke përjashtuar vetëm:

Ishte

Licencë profesionale për tregtimin e artikujve objekt i këtij prokurimi.

Bëhet

Autorizim nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, për tregtimin me shumicë të pajisjeve mjeksore, për rrjedhojë është bërë modifikimi në DST, në zbatim të nenit 42 të ligjit nr.9643, datë 21.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, duke shtyrë dhe datën e hapjes së ofertave më datë 06.06.2019 , ora 10:30.

b. Auditimi mbi dorëzimin, shqyrtimin, klasifikimi dhe shpallja e operatorit ekonomik fitues

Për sa sipër, në bazë të kriterëve dhe kërkesavë të vendosura nga njësia e prokurimit, në bazë të auditimit në SPE të app.gov.al me me numër reference të procedurës REF-20564-05-06-2019, u konstatua se kanë marrë në pjesë 2 (dy) operatorë ekonomik, nga të cilët:

1)K..... shpk me NIPT K....., me ofertë ekonomike 12,461,210 lekë pa tvsh në plotësim të plotë në bazë të kriterëve të kërkuara nga autoriteti kontraktor, duke u shpallur fitues.

2)A..... shpk me NIPT K....., nuk ka paraqitur ofertë ekonomike, ka hedhur në system vetëm ekstraktin historikë, e për pasojë është skualifikuar nga KVO.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN E MJEKËSISË LIGJORE”

Nga auditimi i dokumentacioni të paraqitur në SPE dhe në dokumentacionin e dorëzuar nga operatori ekonomik fitues, për lidhjen e kontratës nr.1404 prot datë 21.06.2019 me vlerë kontrate prej 14,953,452 lekë me tvsh, u konstatua se,

Në pikën 2.1 Kapaciteti ligjor/professional i operatorëve ekonomikë” të Dokumentave të Tenderit kërkohet:

2.1.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të jetë i çertifikuar sipas standarteve ndërkombëtare ISO 9001:2015 të sistemit të menaxhimit të cilësisë.

Çertifikata të jetë e lëshuar të vlefshme të lëshuar nga organe të akredituara kombëtare ose ndërkombëtare për standartizimin dhe të njohura nda DPA (Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit).

Nga operatori ekonomik është paraqitur dhe dorëzuar Çertifikata Ndërkombëtare ISO 9001:2015, me Nr.SB.14.007.01.QMS, lëshuar më 10.01.2019 e vlefshme deri më 29.01.2022, e cila nuk e njohur nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit (DPA organ është i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë), sipas ligjit nr. 9643/2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar neni 23 dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar neni 30 (kërkesat e cilësisë) dhe në bazë të bashkëpunimit të tyre institucional të APP-së me DPA është miratuar Rekomandimi nr. 3330 prot, datë 20.03.2018 “Mbi hartimin e kërkesave të cilësisë”.

Kështu KVO e ngritur me Urdhër nr.889/1 datë 16.04.2019 me përbërje (E.S kryetar, F. M dhe B.P), do të konsideronte një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit në bazë të nenit 66 të VKM nr.914 datë 29.12.2014 i ndryshuar. Në këtë rast operatori ekonomik “K.....” shpk nuk e plotëson të këto kriter dhe shpallja e tij fitues në mënyrë të padrejtë, duke vënë në diskutim cilësinë e procedurave të prokurimeve të financuara nga fondet buxhetore.

Gjithsesi, nga auditimi në sistemin e prokurimeve REF-20564-05-06-2019, meqënëse, kemi pjesëmarrjen e dy operatorëve ekonomikë, ku A.... shpk me NIPT K....., nuk ka paraqitur ofertë ekonomike, ka hedhur në system vetëm ekstraktin historikë, e për pasojë është skualifikuar. Kështu KVO duhej të mbante proces verbal, ku të argumentonte si devijim i vogël dhe që kjo procedurë duhej të realizohej në kushtet e vazhdimësisë së qëllimit kryesor të institucionit të IML-së.

2).Auditimi i procedurës me objekt “Rikonstruksioni i çatisë dhe ambjenteve të brendshme IML”, “kërkesë me propozim” me fond limit në vlerën prej 4,099,712 lekë pa tvsh.

Të dhënat e përgjithshme të tenderit.

Zhvillimi I Procedurës së Prokurimit me objekt : Rikonstruksioni i ambienteve te brendeshme te IML-se		
1. Urdhër Prokurimi nr. 570/1 prot datë 21.03.2019	3. Hartuesit e Dokumenteve/Tenderit nr.570/1 prot datë 21.03.2019 1.A. M 2.A.M 3.B.P	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër nr. 571 dt. 21.03.2019
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit “kërkesë për propozim”	Hartuesi i fondit limit në bazë të urdhërit nr. 570 protdatë 18.03.2019; 1.A.M kryetar	1.E.M kryetar 2.E.S anëtare 3.F.M anëtar



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN E MJEKËSISË LIGJORE”

	2.B.P anëtar 3.A.M anëtar	
5.Fondi Limit (pa tvsh) 4,099,712(katërmilion e nëntëdhjetë e nëntë mijë e shtatëqind e dymbëdhjetë) lekë	6. Oferta fituese (pa tvsh) 2,614.,815 (dymilion e gjashtëqind e katërbëdhjetë mijë e tetëqind e pesëmbëdhjetë) lekë	7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 1.,484.,897 lekë
8. Data e hapjes së tenderit Data 05.04.2019, ora 10:30	9.Burimi Financimit Buxheti i Shtetit	10. Operatorët Ekonomike a)Pjesëmarrës në tender 12 OE b) S'kualifikuar 3 OE
11. Ankimime Nuk ka	12. Përgjigje Ankesës nga AK	13. Përgjigje Ankesës nga KKP
b. Zbatimi I Kontratës së Punimeve		
14. Lidhja e kontratës Nr.1291 datë 06.06.2019, me afat prej 60 ditëve	15. Vlera e kontratës (me tvsh) 3,137,778 (tremilion e njëqind e tridhjetë e shtatë mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë e tetë) leke me tvsh.	
16.Mbikëqyrsi ipunimeve me kontratë nr.1510 prot datë 05.07.2019 dhe kontratë kolaudimi nr.1818 datë 26.08.2019	17.Urdher-shpenzime Nr. 209, datë 09.10.2019, situacioni nr.1	
18- Situacioni Përfundimtar/Faturë Malli;	19.Afati i kontratës në ditë 60 ditë , ngafillimi i punimeve, kanë filluar më 19.08.2019 dhe është në process.	

a. Auditimi në lidhje mbi hartimin e dokumentave të tenderit, hartimin e e specifikimeve teknike:

Nga auditimi rezultoi, se njësia e prokurimit i ngritur në bazë të Urdhër prokurimi nr. 570 prot datë 21.03.2019me përbërje (A.M, A.M dhe B.P) ka mbajtur procesverbalin e datës 22.03.2019, të cilat janë publikuar edhe në sistemin elektronik të Agjencisë së Prokurimeve Publike me numër reference REF -14816-03-21-2019, në lidhje mbi hartimin dhe miratimin e dokumentave të tenderit nga Titullari i AK-së në cilësinë e nëpunësit autorizues, ku u konstatua se :

Grupi i auditimit, konstaton se vendosja e kriterëve (Kapaciteti Teknik) 2. 3.1. (a.b);

-N.P-12 A (Punime të inxhinierisë së mjedisit)

-N.S-4 A (Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniturë me material druri, plastike, metalike dhe xhami dhe rifiniturë të natyrës teknike ndërtuese)

Inxhinier Mjedisi 1

duke mos argumentuar vendosjen e tyre kjo në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 26 (Kontratat për punë publike), pika 5 (Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjestim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentat konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve) si dhe pa mbajtur një procesverbal, ku hartimi i tyre duhej të argumentohej teknikisht dhe ligjërish, mbi përgatitjen e tyre. Ky procesverbal i vihet në dispozicion personit/ave përgjegjës për prokurim, i cili /të cilët e bën/bëjnë pjesë të dosjes së tenderit. Ky veprim është kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”i ndryshuar, neni 61 (hartimi dhe publikimi i dokumentave të tenderit) pika 2.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN E MJEKËSISË LIGJORE”

Gjithashtu, nga auditimi është kërkuar në pikën 2.3.2 (kapaciteti teknik)

2. *Shoqëria duhet të paraqese Çertifikatën e cilësisë së punimeve:*

- EN ISO 9001-2015 (e vlefshme),
- ISO 14001:2015 (e vlefshme),

Në bazë të auditimit të mbi dorëzimit, shqyrtimit, klasifikimi dhe shpallja e operatorit ekonomik fitues, u konstatua se, kanë tenderuar 12 operatorë ekonomikë, nga të cilët janë kualifikuar 10 sipas renditjes si më poshtë:

1. “C.....”shpk me NIPT K..... me vlerë oferte prej 2,614,815 lekë pa tvsh, e cila është shpallur fitues.
2. “O.....” me NIPT K..... me vlerë oferte prej 2,766,745 lekë pa tvsh.
3. “F.....”shpk me NIPT J..... me vlerë ofertë prej 2,937,865 lekë pa tvsh.
4. “S.....” shpk me NIPT L..... me vlerë ofertë prej 3.114,720 lekë pa tvsh.
5. “2.....” shpk me NIPT L..... me vlerë ofertë prej 3,216,500 lekë pa tvsh.
6. “S.....”shpk me NIPT K..... me vlerë ofertë prej 3,312,750 lekë pa tvsh.
7. “K.....” me NIPT K..... me vlerë ofertë prej 3,459,177 lekë pa tvsh.
8. “E.....” me NIPT K..... me vlerë ofertë prej 3,589,793 lekë pa tvsh.
9. “V.....” me NIPT K..... me vlerë ofertë prej 3,605,710 lekë pa tvsh.
10. “K.....” me NIPT L..... me vlerë ofertë prej 4,022,778 lekë pa tvsh.

Janë skualifikuar shoqëria “A.....” shpk dhe “D.....”, në mosplotësimin të kriterëve të kërkuara në DST, në përputhje me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 46.

Nga operatori ekonomik fitues “C.....”shpk janë paraqitur dhe dorëzuar Certifikatat e Sigurisë- EN ISO 9001-2015, ISO 14001:2015, të cilat nuk janë të njohura nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit (DPA organ është i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë), sipas ligjit nr. 9643/2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar neni 23 dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar neni 30 (kërkesat e cilësisë) dhe në bazë të bashkëpunimit të tyre institucional të APP-së me DPA është miratuar Rekomandimi nr.3330 prot datë 20.03.2018 “Mbi hartimin e kërkesave të cilësisë”.

Grupi i auditimit vlerëson se, këto veprime, kanë ardhur si pasojë, pasi AK Instituti i Mjekësisë Ligjore, duke patur në objektin kryesor, dhënien e ekspertizës- shkencore ligjore ka në strukturën e tij pjesën më të madhe mjekë në profesion dhe një numër të vogël të administratës me mungesa të burimeve njerëzore të cilët kryejnë detyra në procedurat e prokurimit, ndaj forcimi i kapaciteteve administrative të autoritetit kontraktor, mbetet një nevojë e vazhdueshme, ku në bashkëpunim me APP, e cila në mënyrë të vazhdueshme në bashkëpunim me Shkollën Shqiptare të Administratës Publike, organizon trajnime për punonjësit e institucioneve qëndrore dhe vendorë të angazhuar me procedurat e prokurimit publik.

b.Ekzekutimi dhe mbikqyrja e kontratës nr.1291 prot datë 06.06.2019 lidhur midis Instituti i Mjekësisë Ligjore përfaqësuar nga nëpunësi autorizues zj.V.S me operatorin ekonomik “C.....”shpk, me vlerë kontrate prej 3,137,778 lekë me tvsh, në neni 15 (ngritja e kantierit) pika 15.3 (*Kontraktori do të nisi punime në objekt vetëm pasi janë marrë të gjitha lejet pranë organeve përkatëse sic e parashikon ligji (njësia bashkiake ose KKT) të gjitha veprimet e*



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN E
MJEKËSISË LIGJORE”

tjera në kundërshtim me këtë kusht ngarkojnë me përgjegjësi kontraktuesin nëse nisin punimet).

Grupi i audituesve, verifikoi ecurinë e punimeve në terren, ku u konstatua se, në bazë të process verbalit të datës 19.08.2019 i mbajtur midis sipërmarrësit të punimeve “C...”shpk, mbikëqyrësi i punimeve dhe përfaqësuesi i AK të IML, mbi fillimin e punimeve.

Në lidhje mbi këto punime është njoftuar dhe Bashkia e Tiranës, me shkresë nr.1782 prot datë 14.08.2019, në bazë të ligjit nr.107/2014, datë 23.04.2009 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” i ndryshuar, në zbatim të nenit 6 të Vendimit nr.408 datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorin” i ndryshuar.

Gjithashtu, në bazë të shkresës nr.12 prot datë 09.10.2019, në bazë të neneve 18 dhe 23 të kontratës nr.1291 prot datë 06.06.2019, është shtyrë realizimi i punimeve me 30 ditë, për shkak se në katin e dytë të ndërtesës si pasojë e aparaturës sensitive ndaj plurave të laboratorit të toksikologjisë, është kërkuar ndërprerje punimesh.

Kështu sa më, sipër punimet kanë rifilluar më data 10.11.2019, si dhe në bazë të shkresës me nr.prot extra datë 25.09.2019 është paraqitur situacioni pjesor me vlerë prej 795,840 lekë, i paguar me Urdhër-shpenzimi nr.209 datë 09.10.2019.

3).Auditimi i procedurës me objekt “Marrje automjete me qira”, “Kërkesë me propozim” realizuar në gusht 2019, me fond limit në vlerën prej 3,840,000 lekë pa tvsh.

a. Auditimi në lidhje mbi përlllogaritjen e fondit limit dhe hartimin e dokumentave të tenderit.

Grupi i auditimit, konstatoi se, kjo procedurë është iniciuar si detyrim shtetëtor midis shtetit Shqiptar dhe Grek, në bazë të VKM nr.742, datë 13.12.2017 “Për zbatim marrëveshjes së bashkëpunimit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Greqisë, për kërkimin, zhvarrimin, identifikimin dhe varrimin e ushtarakëve grekë, të rënë në Shqipëri gjatë luftës Greko-Italiane të viteve 1940-1941, dhe për ndërtimin e vëndprehjes për ta, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, ratifikuar me ligjin nr.10256, datë 25.03.2010”, të Urdhërit të Kryeministrit nr.235 datë 13.12.2017 “Për përcaktimin e përbërjes së ekipit të ekspertëve të palës shqiptare në Komitetin e Përbashkët të ekspertëve shqiptarë dhe grekë për kërkimin, zhvarrimin, identifikimin dhe varrimin e eshtarve të ushtarakëve greke, na zbatim të marrëveshjes së bashkëpunimit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Greqisë, për kërkimin, zhvarrimin, identifikimin dhe varrimin e ushtarakëve grekë, të rënë në Shqipëri gjatë luftës Greko-Italiane të viteve 1940-1941, dhe për ndërtimin e vëndprehjes për ta, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, ratifikuar me ligjin nr.10256, datë 25.03.2010” dhe të Urdhërit nr.236 datë 13.12.2017.

Nga studimi i akteve nënligjore të mësipërme, në asnjë paragraph, nuk është përcaktuar numri i makinave që do të meren me qira. Ky numër është përcaktuar nga vetë AK e Mjeksisë Ligjore, në bazë të koordinimit dhe bashkëpunimit, me institucionet e tjera shqiptare që janë pjesë e grupit të punës, sipas pikave të vendodhjes së eshtarve dhe grafikët e punimeve që do të realizohen nga pala shqiptare me atë greke.

Kështu, në bazë të VKM nr.742, datë 13.12.2017 “Për zbatim marrëveshjes së bashkëpunimit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Greqisë, për kërkimin, zhvarrimin, identifikimin dhe varrimin e ushtarakëve grekë, të rënë në Shqipëri gjatë luftës Greko-Italiane të viteve 1940-1941, dhe për ndërtimin e vëndprehjes për ta, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, ratifikuar me ligjin nr.10256, datë



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN E MJEKËSISË LIGJORE”

25.03.2010” dhe nevojës aktuale për të patur 3 automjete në dispozicion , për realizimin e këtij shërbimi, nga ana e Institutit të Mjekësisë Ligjore, është ngritur grupi i punës, sipas Urdhërit të titullarit të AK-së nr.1703 datë 05.08.2019 , i cili ka testuar tregun , për përlloraritjen e fondit limit, sipas me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 57, si më poshtë vijon:

Bazuar në ofertat e tregut:

-C..... shpk me NIPT J..... me ofertë në vlerë prej 100,000 lekë pa tvsh/muaj.

-T.....shpk me NIPT K..... me ofertë në vlerë prej 111,500 lekë pa tvsh/muaj.

-H.....shpk me NIPT K.... me vlerë në vlerë 108,000 lekë pa tvsh/muaj.

Kështu sa më sipër, është miratuar nga AK, urdhër nr.1704 prot datë 05.06.2019, me vlerë prej 3,840,000 lekë pa tvsh, marrjen me qira me qëllimin sipas VKM nr.742, datë 13.12.2017, për vitin 2018-2019.

Të dhënat e përgjithshme të tenderit:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : Marrje me qira të 3 automjeteve për nevoja të Institucionit		
1. Urdhër Prokurimi nr. 1704 prot datë 05.08.2019	3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit nr.1704 prot datë 05.08.2019 1.A.M 2.Z.I 3.M.K (Ç) Hartuesi i fondit limit në bazë të urdhërit nr. 570 prot datë 18.03.2019; 1.A.M 2.B.P 3.A.M	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër nr. 571 dt. 21.03.2019 1.E.S kryetar 2.F.M anëtare 3.S.B anëtar
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit “kërkesë për propozim”		
5.Fondi Limit (pa tvsh) 3.840.000 (tremilion e tetëqind e dyzet e mijë) lekë. Për vitin 2019 vlera prej 1,280,000 (njëmilion e dyqind e tetëdhjetë mijë) lekë Për vitin 2020 vlera prej 2,560,000 (dymilion e pesëqind e gjashtëdhjetë mijë) lekë.	6. Oferta fituese (pa tvsh) 3,834,000 (tremilion e tetëqind e tridhjetë e katër mijë) lekë	7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 6000 lekë
8. Data e hapjes së tenderit Data 19.08.2019, ora 10:30	9.Burimi Financimit Buxheti i Shtetit	10. Operatorët Ekonomike a)Pjesëmarrës në tender 2 OE b) S’kualifikuar 1 OE
11. Ankimime Nuk ka	12. Përgjigje Ankesës nga AK	13. Përgjigje Ankesës nga KKP
b. Zbatimi i Kontratës së qirase se automjeteve		
14. Lidhja e kontratës Nr.1949 datë 13.09.2019, me afat prej 12 muajve	15. Vlera e kontratës (me tvsh) 4,600,800 (katërmilion e gjashtëqind mijë e tetëqind) lekë me tvsh.	
16.	17.Urdher-shpenzime Nr. 210, datë 09.10.2019 dhe nr.235, datë 13.11.2019	

b.Auditimi mbi dorëzimin, shqyrtimin, klasifikimi dhe shpallja e operatorit ekonomik fitues.

Për sa sipër, në bazë të kriterëve dhe kërkesavë të vendosura nga njësia e prokurimit, në bazë të auditimit në SPE të app.gov.al me me numër reference të procedurës REF-32866-08-06-2019, u konstatua se kanë marrë në pjesë 2 (dy) operatorë ekonomik, nga të cilët:

1)C..... shpk me NIPT K....., me ofertë ekonomike 3,834,000 lekë pa tvsh në plotësim të plotë në bazë të kriterëve të kërkuara nga autoriteti kontraktor, duke u shpallur fitues.



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN E MJEKËSISË LIGJORE”

2)A.....shpk me NIPT K....., është skualifikuar, për mungesë të dokumentacionit të specifikimeve të mëposhtme, KVO e ngritur me urdhër nr.1705 prot datë 05.08.2019, në mosplotësimim të kritereve të kërkuara në DST, në përputhje me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 46, konkretisht :

-motori turbo diesel është kërkuar Min 2.2 ndërsa operatori e ka paraqitur 2.0;

-lartësia nga toka është kërkuar Min; 190 mm ndërsa operatori ekonomik e ka paraqitur 188 mm;

c. Ekzekutimi dhe mbikqyrja e kontratës nr.1949 prot datë 13.09.2019 lidhur midis Instituti i Mjeksisë Ligjore përfaqësuar nga nëpunësi autorizues zj.V.S me operatorin ekonomik “C.....”shpk, me vlerë qeraje mujore për të tre automjetet është pa tvsh 319,500 lekë pa tvsh dhe vlerë totale

Në lidhje mbi realizimin e këtij shërbimi për muajin tetor 2019, grupi i audituesve, konstatoi se, nga Autoriteti Kontraktor i Institutit të Mjeksisë Ligjore, sipas qëllimit të VKM nr.742, datë 13.12.2017, janë përgatitur Autorizimet përkatëse për ekspertet me ose pa shofer(sipas grafikut të hartuar nga Ministria e Mbrojtjes për gërmimet e varreve), të cilëve iu sigurohej karburanti dhe dietat ditore, ndërsa pjesa në rast difekteve teknike të mjeteve (deri në momentin e përgatitjes së materialit nuk kishte ndodhur), ku përfshihen (ndërrime pjesësh, konsumim goma, ferrota frena, disqe frenash, fshirëse xhami, amortizator, gomina etj, të cilat janë marrë përsipër nga operatori ekonomik fitues, në bazë të kërkesave të vendosura nga AK në DST.

Për sa më sipër, audituesit e KLSH-së, vlerësojnë, nëse nga AK do të ishte planifikuar në PBA e vitit 2019, në zërin buxhetor (231) për blerjen e automjeteve të përdorura, në fund të shërbimit mjetet motorike do të rregjistroheshin në vlerën e kontabilitet të institucionit, duke marrë performancë maksimale positive në lidhje me efektivitetin, ekonomikitetin dhe eficientën, të fondeve buxhetore.

Për sa konstatuar më sipër, vendosja e kërkesave specifike dhe termat e referencave, nga autoriteti kontraktor i Institutit të Mjeksisë Ligjore (IML), duhej të argumentoheshin në mënyrë të plotë në planin ligjor dhe teknik, me qëllimin që procedurat e prokurimeve publike të realizohen në përputhshmëri të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, VKM nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, duke siguruar integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat tenderuese, me qëllim mirë përdorim me efektivitet, ekonomikitet dhe eficientë, të fondeve publike me burim financimi Buxhetin e Shtetit.

Gjithashtu, këto veprime , kanë ardhur si pasojë, pasi AK i Institutit të Mjeksisë Ligjore, duke patur në objektin kryesor, dhënien e ekspertizës- shkencore ligjore ka në strukturën e tij pjesën më të madhe mjekë në profesion dhe një numër të vogël të administratës me mungesa të burimeve njerëzore të cilët kryejnë detyra në procedurat e prokurimit, ndaj forcimi i kapaciteteve administrative të autoritetit kontraktor, mbetet një nevojë e vazhdueshme, ku në bashkëpunim me APP, e cila në mënyrë të vazhdueshme në bashkëpunim me Shkollën Shqiptare të Administratës Publike, organizon trajnime për punonjësit e institucioneve qëndrore dhe vendorë të angazhuar me procedurat e prokurimit publik.

4. Mbi caktimin e nëpunësit Autorizues në IML

Nga auditimi në Institutin e Mjeksisë Ligjore, në bazë të dokumentacionit të vënë në dispozicion të realizimit të procedurave dhe ekzekutimit të prokurimeve publike, sipas ligjit nr.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN E MJEKËSISË LIGJORE”

9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 56 (titullari i autoritetit kontraktor ose zyrtari i autorizuar), u konstatua se, në cilësinë e Nëpunësit Autorizues (NA), nuk është drejtuesi i institucionit z.B.X, por zj.V.S me detyrë përgjegjës sektori në sektorin e menaxhimit të akteve dhe laboratorit, sipas shkresave të Ministrisë së Drejtësisë nr.5083prot datë 22.09.2017 dhe nga Ministria e Financave nr.12396/1 prot datë 19.09.2017 me lëndë “Mbi caktimin e Nëpunësit Autorizues të Përkohshëm për IML” sipas rrethanave faktike dhe juridike, si më poshtë vijon:

-Instituti i Mjekësisë Ligjore, është institucion në varësi të Ministrit të Drejtësisë, i cili me fillimin e efekteve juridike të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, është përfshirë në skemën e administrimit të shërbimit civil.

-Nga auditimi, u konstatua se, B.X gëzon statusin e nëpunësit civil, pasi ka filluar marrëdhënien e punës në këtë institucion, me aktin administrative nr.5762/1 datë 26.11.2013, të ministrit, në pozicionin “Drejtor i Institutit të Mjekësisë ligjore” të cilin e ka mbajtur deri më datë 20.06.2017, deri në daljen e aktit administrative nga ish-Ministri i Drejtësisë me shkresë nr.4052/3 datë 20.06.2017 “Njoftim mbi fillimin e ecurisë disiplinore” e shoqëruar me vendimin përfundimtar nr.4052/8 datë 28.06.2017 “Për marrjen e masës disiplinore “largim nga shërbimi civil” për z.B.X.”

Për sa më sipër, Z.X e ka ankimuar këtë vendim, duke rifituar vendin e punës dhe rikthimi në detyrë në bazë të vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë nr.3462 datë 13.09.2017, me ekzekutimi të përkohshëm, ka marrë formë të prerë, deri në momentin e vendimit të Gjykatës së Apelit Administrative (është në process ankimi nga MD).

-Momentalisht, këtë detyrë e ushtron zj.V.S me detyrë përgjegjës sektori në sektorin e menaxhimit të akteve dhe laboratorit, në bazë të shkresave të sipër cituara.

-Në bazë të “Rregullores për organizimin dhe funksionimin e Institutit të Mjekësisë Ligjore” neni 60, janë të përcaktuara detyrimet ligjore të pozicionit të Drejtorit të IML, specifikisht, ky nen përcakton se:

“Drejtori i I.M.L-së është Titullari i Institutit të Mjekësisë Ligjore.

Ai drejton dhe kontrollon veprimtarinë në sistemin e përgjithshëm të ekspertimit mjeko-ligjor, sipas kompetencave të parashikuara në këtë Rregullore.

Drejtori ka të drejtën dhe autoritetin të përfaqësojë I.M.L-në marrëdhënie me të tretët.

Drejtori i I.M.L-së mban përgjegjësi për ligjshmërinë e veprimeve të tij dhe stafit gjatë kryerjes së detyrës dhe kur nuk është i bindur për ligjshmërinë e urdhërave dhe vendimeve që zbaton duhet të informojë menjëherë organet eprorë. Ai nuk është i detyruar të zbatojë një urdhër të paligjshëm.

Drejtori miraton planet e punës të sektorëve në varësi të tij dhe paraqet për miratim në Ministrinë e Drejtësisë planet e punës tremujore dhe vjetore.

Në zbatim të kompetencave të tij, për zbatimin e detyrave nga vartësit, Drejtori nxjerr Urdhëra dhe Udhëzime, të cilat janë të detyrueshme për zbatim nga të gjitha strukturat e I.M.L-së.

Kërkon dhe kontrollon nga të gjithë ekspertët e I.M.L-së, personelin teknik e administrative kryerjen e detyrës me profesionalizëm e korrektësi dhe mbikqyr zbatimin e akteve ligjore e nënligjore në fuqi.”

Grupi i audituesve, vlerëson se, qartësisht disa prej funksioneve të Drejtorit të IML, kufizohen për shkak –pasojë të mospasjes së cilësisë së pozicionit të Nëpunësit Autorizues (NA), kjo në kundërshtim të ligjit nr.9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar neni 19, ligji nr.10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar neni 12, për rrjedhojë dhe ushtrimin e



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN E MJEKËSISË LIGJORE”

kompetencave në fushën e prokurimeve publike në zbatim të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 56 (titullari i autoritetit kontraktor ose zyrtari i autorizuar).

Si përfundim, grupi i auditimit, vlerëson se ka vonesë të zgjatur në lidhje me miratimin e nëpunësit autorizues (NA) nga Ministria e Drejtësisë në koordinim me Ministrinë e Financave, pasi sipas situatës së mësipërme ky vendim është marrë i mirëqënë dhe si rrjedhojë me ardhjen në detyrë të z.B.X (Drejtor IML) duhet që t’i kalonin dhe detyrat e NA që janë të përcaktuara në bazë të ligjit nr.9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar neni 19, ligji nr.10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar neni 12, për rrjedhojë dhe ushtrimin e kompetencave në fushën e prokurimeve publike në zbatim të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 56 (titullari i autoritetit kontraktor ose zyrtari i autorizuar).

Gjithashtu, nga auditimi rezulton se nga Ministria e Drejtësisë, nuk është berë ende një kërkesë pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për ndryshimin e Nëpunësit Autorizues të Përkohshëm, ndonëse nga IML me shkresat nr1616 prot datë 21.09.2018 dhe nr.1855 prot datë 09.03.2019, është kërkuar ndryshimi respektiv për caktimin e titullarit të institucionit në pozicionin e nëpunësit autorizues.(Materiali i pikës III, është pjesë e materialit dhe të Ministrisë së Drejtësisë)

Në lidhje mbi mangësitë e evidentuara më sipër, grupi i audituesve të KLSH-së ka mbajtur Akkonstatimin Nr.3 datë 25.11.2019, regjistruar në IML me nr. 12360 prot, datë 25.11.2019, për të cilin nga subjekti i audituar nuk ka pasur observime, deri në momentin e hartimit të këtij materiali, kështu problemet e trajtuara po konsiderohen të mirëqena.

Prokurimet e fondeve publike për mallra, punë dhe shërbime “Blerje me vlerë të vogël”.

Në zbatim të programit të auditimit, dhe drejtimit të mësipërm u auditua përputhshmëria e veprimtarisë së subjektit me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi dhe verikimin nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet e raportuara janë në përputhje me bazën e parimeve të profesionalizmit, të efikasitetit, të përgjegjësisë dhe korrektësisë në zbatimin e legjislacionit në fuqi, në bazë të të cilit ushtron veprimtarinë subjekti që auditohet.

Gjatë auditimit, grupi i audituesve të KLSH-së,u fokusua në zbatimin e bazës ligjore dhe nënligjore ligji nr. 9646 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, VKM nr.918 datë 29.12.2014 “Për kryerjen e procedurave të prokurimit publik në mënyrë elektronike”, Udhëzim e APP-së nr. 2 datë 27.01.2015 “Për hartimin e regjistrit të parashikimeve të prokurimit publik dhe regjistrit të realizimeve të prokurimit publik”, ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik.” ligjit nr.80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN E MJEKËSISË LIGJORE”

shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, si dhe çdo akti juridike që është në fuqi në lidhje mbi prokurimet publike të financuara nga Buxheti i Shtetit.

Nga auditimi i dokumentacionit të mësipërm për periudhën Janar-Tetor 2019, në vija të përgjithshme rezultoi:

Për periudhën Janar-Tetor 2016 janë realizuar gjithsej 23 procedura prokurimi, ku 5 prej tyre janë nën vlerën 100,000 lekë, dhe 18 të tjera midis vlerës 100,000-800,000 lekë. . Kryesisht janë zhvilluar prokurime për blerjen e materialeve të zyrës, kancelari, riparim ambjentesh etj., Nga këto u audituan 20 procedura gjithsej, me fond **22,956.206 lekë** ose **72%** e fondit të shpenzuar për vitin 2019, për realizimin e procedurave të prokurimit.

PROTOKOLLI I PROKURIMEVE VITI 2019						
NR	DATA e Planifikuar	EMËRTIMI I PROKURIMIT	FONDI LIMIT (LEKE PA TVSH)	Të realizuara pa TVSH	Fonde te mbetura (pa TVSH)	PROCEDURA E PËRDORUR
1	24.06.2019	Internet	166,667	166,667	-	Blerje me vlerë të vogël
2	27.07.2019	Kancelari	250,000	182,000	68,000	Blerje me vlerë të vogël
3	8.08.2019	Materiale dhe pajisje laboratorike	12,508,333	12,461,210	47,123	Blerje me vlerë të vogël
4	11.08.2019	Materiale dhe pajisje laboratorike	490,000	294,000	196,000	Blerje me vlerë të vogël
5	19.08.2019	Materiale pajisjeve speciale	800,000	310,000	490,000	Blerje me vlerë të vogël
6	17.10.2019	Materiale pajisjeve te zyrës	80,000	67,300	12,700	Blerje me vlerë të vogël nën 100 000 leke
7	17.10.2019	Materiale per pastrim, dezinfektim,	416,667	387,300	29,367	Blerje me vlerë të vogël
8	07.11.2019	Pjese kembimi goma dhe bateri	34,900	34,900	-	Blerje me vlerë të vogël nën 100 000 leke
9	07.11.2019	Sherbime te pastrimit gjelberimit	26,000	26,000	-	Blerje me vlerë të vogël nën 100 000 leke
10	16.12.2019	Sherbime te tjera	594,890	254,240	340,650	Blerje me vlerë të vogël
11	16.12.2019	Sherbime telefonike	127,500	120,000	7,500	Blerje me vlerë të vogël
12	28.12.2019	Shpenzime per mirembajtjen	960,000	796,500	163,500	Blerje me vlerë të vogël
13	29.12.2019	shpenzime per pritje percjellje	133,333	52,960	80,373	Blerje me vlerë të vogël
14	29.12.2019	Shpenzime per sig. e ndertesave	664,583	797,500	-132,917	Blerje me vlerë të vogël
15	27.07.2019	te tjera materiale dhe sherbime	800,000	713,333	86,667	Blerje me vlerë të vogël
16	8.08.2019	Udhetime jashte shtetit	416,667	221,125	195,542	Blerje me vlerë të vogël
17	11.08.2019	Karburant dhe vaj	25,000		25,000	Blerje me vlerë të vogël nën 100 000 leke
18	19.08.2019	Shpenzime mirembajtjen zyres	680,000		680,000	Blerje me vlerë të vogël
19	17.10.2019	Libra dhe publikime profesionale	320,000		320,000	Blerje me vlerë të vogël nen 100 000 leke
20	17.10.2019	Shpenzime mirembajtjen e objekteve ndertimore	-		-	Nuk është realizuar
21	07.11.2019	Karburant dhe vaj	3,333,333			Blerje me vlerë të vogël
22	07.11.2019	Shpenzime transporteve	-		-	Nuk është realizuar



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN E
MJEKËSISË LIGJORE”

23	16,12,2019	Shpenzime siguracion te mjeteve te transportit	45,000	54,000	- 9,000	Blerje me vlerë të vogël nën 100 000 leke
24	16,12,2019	Shpenzime per prodhim dokumentacioni specifik	83,333	23,500	59,833	Blerje me vlerë të vogël nën 100 000 leke
25	28,12,2019	Plehra kimik, furnitura veterinare,	-		-	Nuk është realizuar
26	29,12,2019	Deratizim dhe dezinfektim	83,333	81,000	2,333	Blerje me vlerë të vogël nën 100 000 leke
		TOTAL	22,956.206	16,796,535	2,826,338	

Nga auditimi i këtyre procedurave me zgjedhje, në vija të përgjithshme u konstatua se:

1. Në të gjitha rastet e përdorimit të formës së prokurimit “Blerje me vlerë të vogël”, fondi limit ka qenë deri në 800,000 lekë pa TVSH. pra brenda kufirit monetar të përcaktuar me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për rregullat e prokurimit publik”, kreu II, pika 2 si dhe udhëzimin e APP nr. 3, datë 27.01.2015 “Për procedurën e prokurimit me vlera të vogla”, Udhëzimit nr 3, dt 08.01.2018 të APP “Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”, Udhëzimit nr. 11, dt 30.05.2018 të APP , Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 3, dt 08.01.2018 “Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”, të ndryshuar.

2. Nga Komisioni i Prokurimit me Vlera të Vogla është zbatuar limiti i përcaktuar për prokurimet me vlera të vogla i cili nuk është tejkaluar në asnjë rast.

3. Në dosjen e prokurimeve me vlera të vogla ndodheshin faturat tatimore shitje të cilat rezultuan të njëjta me vlerën e ofertuar si dhe me urdhër shpenzimet përkatëse.

4. Titullari i institucionit me urdhër të brendshëm ka urdhëruar ngritjen e komisionit të marrjes në dorëzim të mallrave dhe shërbimeve të prokuruarra për cdo vit veprimi. Nga komisionet marrjes në dorëzim janë mbajtur procesverbalet e marrjes në dorëzim për kontrollin fizik të mallrave në sasi dhe cilësi të cilat ndodheshin fletë hyrjet e magazinës me vlera të njëjta me faturat tatimore të shitjes.

5. Konstatohet se në të gjitha procedurat nuk administrohet proces-verbali për llogaritjen e fondit limit. Në të gjitha praktikat e blerjeve me vlerë të vogël përgjatë vitit 2019 përlllogaritja e fondit limit është bërë bazuar cmimeve të blerjeve të vitit 2018 bazuar në tabelën përkatëse të pa firmosur nga komisioni i blerjeve të vogla për vitin 2018.

6. Konstatohet se nuk janë përcaktuar specifikimet teknike dhe kriteret e kualifikimit rast pas rasti në kundërshtim me përcaktimet e bëra në nenin 23 të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, pikën 5/a-c të nenit 27, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar.

7. Në prokurimet me vlerë të vogël është llogaritur për cdo rast fondi limit para daljes së urdhër prokurimit, por pasqyrat e llogaritjes nuk janë administruar në dokumentacionin prokurues. Për mallrat e prokuruarra me blerje të vogla nuk është përpiluar procesverbali i marrjes në dorëzim para hyrjes në magazinë.

Blerje me Vlerë të Vogël Janar-Tetor 2019

REF-10463-02-25-2019 Objekti: - Blerje detergjentë

Nga verifikimi i kësaj procedure rezulton se : I rregullt urdhëri i prokurimit dhe ftesa për ofertë. Pjesëmarës janë 21 OE. 12 OE janë kualifikuar, ndërsa 9 OE janë skualifikuar. Në dosje nuk administrohet proces-verbal për arsyet e skualifikimit të 9 OE. Fitues është shpallur



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN E
MJEKËSISË LIGJORE”

OE me ofertën më të ulët . Në mbështetje të nenit 64 të VKM nr.914, datë 29.12.2014 “RPP” të ndryshuar, në dosje nuk janë administruar Deklaratat e Konfliktit të Interesit të firmosura nga anëtarët e KVO.

REF-19363-04-24-2019 Objekti: - Blerje boje per printera

I rregullt urdhëri i prokurimit dhe ftesa për ofertë. Në këtë procedurë kanë marrë pjesë 17 OE. Janë kualifikuar 12 dhe janë skualifikuar 7 OE. Nuk është mbajtur procesverbal në lidhje me skualifikimin e 7 OE dhe për arsyet pse janë skualifikuar.

Fitues është shpallur subjekti i renditur i pari A...K..... me cmimin më të ulët. Fituesi i procedurës A..... K.....ka lëshuar autorizim për pjesëmarrje z.A..... A..... në procedurën e prokurimit publik datë 13.08.2019. Autorizimi mban datën e lëshimit 14.08.2019, ndërkohë që procedura është bërë një ditë më parë.

REF-04275-01-18-2019 Objekti: - Transport përpunim dhe evadim i mbetjeve të rrezikshme spitalore.

Nga verifikimi i kësaj procedure rezulton se: Është i rregullt urdhëri i prokurimit dhe ftesa për ofertë. Pjesëmarrës 1 OE. Nuk është bërë perlllogaritja e fondit limit të mallrave / punëve/ shërbimeve si detyrim i përcaktuar. Kjo bie në kundërshtim me pikën 5 të Udhezimit nr. 3, datë 08.01.2018 “Mi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël” të ndryshuar.

Në mbështetje të nenit 64 të VKM nr.914, datë 29.12.2014 “RPP” të ndryshuar, nuk janë administruar Deklaratat e Konfliktit të Interesit të firmosura nga anëtarët e KVO.

REF-08313-02-15-2019 Objekti: - Bilete avioni për 1 person Athinë Tiranë Athinë

Nga verifikimi i kësaj procedure rezulton se : Është i rregullt urdhëri i prokurimit dhe ftesa për ofertë. Në këtë procedurë kanë marrë pjesë 2 OE. Fitues OE me ofertën më të ulët . Nuk është bërë perlllogaritja e fondit limit të mallrave / punëve/ shërbimeve si detyrim i përcaktuar në pikën 5 të Udhezimit nr.3, datë 08.01.2018 “Mi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël” të ndryshuar. Në urdhër shpenzim të datës 07.05.2019 është përfshirë bileta dhe akomodim për katër netë në hotel me 4 yje. Në dosje nuk administrohet asnjë faturë e lëshuar nga hoteli në të cilin është akomoduar personi pjesëmarrës në takim. Në dosje nuk gjendet gjithashtu asnjë shkresë mbi aktivitetin që do të jetë i pranishëm personi nga Instituti i Mjeksisë Ligjore.

REF-36046-09-16-2019 Objekti: -Bilete avioni per 1 person.

Nisja date 18.09.2019 (pa bagazhe) Tirane– Vjene Vjene – Hamburg, (tranzit) dhe kthimi date 21.09.2019 Hamburg –Frankfurt dhe Frankfurt – Tirane (tranzit). Nga verifikimi i kësaj procedure rezulton se : Është i rregullt urdhëri i prokurimit dhe ftesa për ofertë. Në këtë procedurë kanë marrë pjesë 2 OE. Fitues OE me ofertën më të ulët . Nuk është bërë perlllogaritja e fondit limit të mallrave / punëve/ shërbimeve si detyrim i përcaktuar në pikën 5 të Udhezimit nr.3, datë 08.01.2018 “Mi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël” të ndryshuar. Në urdhër shpenzim të datës 18.05.2019 është përfshirë bileta dhe akomodim për tre netë në hotel. Në dosje nuk administrohet asnjë faturë e lëshuar nga hoteli në të cilin është akomoduar personi pjesëmarrës në takim. Në dosje nuk gjendet gjithashtu asnjë shkresë mbi aktivitetin që do të jetë i pranishëm personi nga Instituti i Mjeksisë Ligjore.

REF-08314-02-15-2019 Objekti: - Akomodim dhe fjetje ne hotel me 4 yje për një person katër netë e pesë ditë



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN E MJEKËSISË LIGJORE”

Nga verifikimi i bërë dosjes rezultoi i rregullt urdhëri i prokurimit dhe ftesa për ofertë. Pjesëmarrës janë 6 OE. 4 OE janë kualifikuar, 2 OE janë skualifikuar, Nga kontrolli i procedurës nuk administrohet në dosje arsyeja e skualifikimit dhe KVO nuka ka mbajtur proces verbal komisioni për skualifikimin e dy operatorëve. Në dosje nuk administrohet asnjë faturë e lëshuar nga hoteli në të cilin është akomoduar personi pjesëmarrës në takim.

REF-17365-04-10-2019 Objekti: - Bilete avioni për 1 person Athinë -Tiranë -Athinë

Nga verifikimi i kësaj procedure rezultoi se : Është i rregullt urdhëri i prokurimit dhe ftesa për ofertë. Në këtë procedurë kanë marrë pjesë 7 OE. 4 OE janë kualifikuar, ndërsa 3 OE janë skualifikuar. Nuk është mbajtur proces verbal për arsyet e skualifikimit të 3 OE.

Në këtë procedure rezultojnë që dy ofertat me çmimin më të vogël kanë patur të njëjtin çmim. Nuk është zbatuar procedura për mbajtjen e shortit për subjektet që rezultuan me të njëjtin çmim. Kjo bie në kundërshtim me **Vendimin Nr. 914, datë 29.12.2014 “ Për Miratimin e rregullave të prokurimit publik”**, Neni 66 pika 8. “ Nëse dy ose më shumë oferta kanë të njëjtin çmim më të ulët ose kanë pikë të njëjta, atëherë fituesi do të përcaktohet me short, në prani të ofertuesve” .

Konkluzion:

Nga auditimi me zgjedhje të procedurave të prokurimit për periudhën Janar - Tetor 2019, konstatohet se në shumë raste nuk janë respektuar përcaktimet e bëra në kuadrin ligjor të prokurimeve publike, kryesisht të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, konkretisht në administrimin e dokumentacionit të përcaktuar që duhet të ketë një procedurë prokurimi, mungesën e llogaritjes së fondit limit, etj.

U trajtua observacioni nr.2676 prot. datë 02.12.2019 i paraqitur nga Z. B.X me detyrë Drejtor në të cilën trajtohet se, →Në vijim të Akt-Konstatimit tuaj Nr. 2 në lidhje me programin e auditimit nr. 813/1, datë 18.10.2019, për periudhën e auditimit 01.01.2019-30.10.2019.... në bazë dhe për zbatim të ligjit, nr. 9646, datë 20.11.2006, “Për prokurimin Publik”, dhe të VKM-së nr.918, datë 29.12.2014 “Për kryerjen e procedurave të prokurimit publik në mënyrë elektronike”, ju parashtrojmë observacionet si më poshtë vijon: deklaratat e konfliktit të interesit, janë të arshivuara te dosja e prokurimeve të cilën e kemi depozituar në protokoll. Për përzgjedhjen e fituesit në -REF-17365-04-10-2019- Bilete avioni për 1 person Athinë-Tiranë-Athinë kemi mbajtur një proces-verbal, pasi është hedhur shorti në prezencë të dy operatorëve nga ku rezultoi që shorti i ra operatorit A..... Në dosje e -REF-08314-02-15-2019 me objekt -Akomodim dhe fjetje në hotel me 4 yje për një person katër netë e pesë ditë është një faturë tatimore ku reflekton qëndrimin dhe akomodimin e personit në hotel, mbi bazën e të cilës është bërë dhe likuidimi në thesar. Përlllogaritja e fondit limit në -REF-36046-09-16-2019 me objekt Biletë avioni për 1 person është bazuar në çmimet e vitit të mëparshëm.

Qëndrimi i audituesve shtetërorë të KLSH-së

-Lidhur me sa ju trajtoni për marrjen dijeni sqarojmë se vet akt-konstatimi është një dokument për vënien tuaj në dijeni zyrtarisht, veç trajtimit verbal i cili është realizuar me drejtuesit e strukturave nën varësinë tuaj por edhe me Ju gjatë ballafaqimi përfundimtar në ambientet tuaja. Ju jeni përcaktuar në material si epror i IML, ndërsa çështjet teknike janë trajtuar vazhdimisht me personelin përgjegjës për detyrat megjithatë nëpërmjet akt-konstatimit të lënë, jeni ftuar të paraqisni gjithçka mbi situatën lidhur me mangësitë e evidentuara të cilat ju vlerësoni se ju përkasin. Në observimin tuaj ju paraqisni



KONTROLLI I LARTË I SHETIT
Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN E
MJEKËSISË LIGJORE”

dokumentacion mbi çështjet konkrete si, deklaratat e konfliktit të interesit, procesverblin për hedhjen e shortit, faturë tatimore ku reflekton qëndrimin dhe akomodimin e personit në hotel, , megjithatë këto dokumenta duhet të ishin në dosjet përkatëse në momentin e auditimit, dhe jo të arkivuara sëbashku në dosje të vecanta në protokoll. Pretendimi juaj në këtë rast gjen vend.

- Sa më sipër observacioni juaj merret në konsideratë pjesërisht.

U trajtua observacioni i IML nr.2756 prot. datë 13.12.2019 regjistruar në KLSH me nr.813/3 datë 16.12.2019 lidhur me projektraportin e dërguar. Në këtë obeservacion paraqiten pretendime lidhur me procedurat për blerje të vogla dhe procedurën për blerje reagentësh:

Qëndrimi i audituesve shtetërorë të KLSH^{-së}

Mbi procedurat e prokurimit për blerjet e vogla qëndrimi ynë është shprehur në observacionin e mësipërm. Lidhur me procedurën e blerjes së reagentëve sqarojmë se, grupi i auditimit i qëndron trajtimit në projektraport dhe pasqyruar edhe në këtë Raport Përfundimtar Auditimi.

Titulli i Gjetjes nr.1:	Vleresimi i përputhshmërisë dhe rregullshmërisë financiare të realizimit të prokurimeve publike për periudhën e auditimit 01.01.2019 deri në 31.10.2019 sipas ligjit nr 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”i ndryshuar dhe ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe ligjit nr.9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” .
Situata:	<p>-Nga auditimi i të gjitha objekteve tenderuese kryesisht për mallra/punë (për shkak të specifikës së detyrës funksionale të institucionit të IML, konkretisht procedurat me objekt:</p> <ul style="list-style-type: none">-“Blerje reagentësh dhe materiale laboratorike” me fond limit 12,508,333 lekë pa tvsh;-“Blerje pajisje për autopsinë”, me fond limit 4,183,333 lekë pa tvsh-“Rikonstrukcioni i çatisë dhe ambjenteve të brendshme IML”, me fond limit 4,099,712 lekë pa tvsh <p>u konstatua se IML, si Autoritet Kontraktor, ka numër të kufizuar të administratës me burime njerëzore, për shkak të strukturës me numër të vogël, të cilët rezultuan të pa trajnuar në mënyrë periodike pranë Agjencisë së Prokurimeve Publike (APP), për pasojë janë evidentuar paqartësi në hartimin e kriteve të veçanta për kualifikim dhe specifikimeve teknike (në këto struktura janë angazhuar mjekë specialist të fushës), të cilët duhet t’i paraqisnin vendosjen e tyre në mënyrë të hollësishme duke e argumentuar, duke mbajtur një procesverbal, në mbështetje të ligjit nr.9646 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”i ndryshuar, neni 27(kontrata e mallrave), neni 26 (kontrata punë) neni 61 (hartimi dhe publikimi i dokumentave të tenderit).</p> <p>-Nga auditimi u konstatua se, nga titullari i AK, për periudhën 01.01.2019 deri në 30.10.2019, nuk është caktuar personi përgjegjës për prokurimin, kjo në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”i ndryshuar, neni 57, i ndryshuar me VKM nr.797, datë 29.12.2017 “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr.914, datë datë 29.12.2014</p>



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN E MJEKËSISË LIGJORE”

	<p>”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik.”</p> <p>-Gjithashtu, nga auditimi u konstatua se, Nëpunësi Zbatues, është aktivizuar në disa struktura të prokurimeve publike (në hartimin e fondit limit; në njësinë e prokurimit dhe në ekzekutimin e kontratës), veprime të cilat bien ndesh me ligjin nr.9646 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”i ndryshuar, ligjit nr.9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe ligji nr.10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar.</p>
Kriteri:	Ligji nr 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”i ndryshuar, neni 27(kontrata e mallrave), neni 26 (kontrata punë) neni 61 (hartimi dhe publikimi i dokumentave të tenderit), ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin.”
Ndikimi/Efekti:	Mos argumenti i vendosjes së kriterëve të veçanta në mënyrë të qartë teknike dhe ligjore, mund të sjellë uljen e operatorëve ekonomike në procedura prokuruese.
Shkaku:	Këto veprime , kanë ardhur si pasojë, pasi AK Instituti i Mjekësisë Ligjore, duke patur në objektin kryesor, dhënien e ekspertizës- shkencore ligjore ka në strukturën e tij pjesën më të madhe mjekë në profesion dhe një numër të vogël të administratës me mungesa të burimeve njerëzore të cilët kryejnë detyra në procedurat e prokurimit, ndaj forcimi i kapaciteteve administrative të autoritetit kontraktor, mbetet një nevojë e vazhdueshme, ku në bashkëpunim me APP, e cila në mënyrë të vazhdueshme në bashkëpunim me Shkollën Shqiptare të Administratës Publike, organizon trajnime për punonjësit e institucioneve qëndrore dhe vendorë të angazhuar me procedurat e prokurimit publik.
Rëndësia:	E mesme

Titulli i Gjetjes nr. 2:	Përputhshmërisë dhe rregullshmërisë financiare të përcaktimit dhe emërimit në pozicionin e Nëpunësit Autorizues (NA), pranë Institutit të Mjekësisë Ligjore.
Situata:	<p>Nga auditimi në Institutin e Mjekësisë Ligjore, në bazë të dokumentacionit të vënë në dispozicion të realizimit të procedurave dhe ekzekutimit të prokurimeve publike, sipas ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 56 (titullari i autoritetit kontraktor ose zyrtari i autorizuar), u konstatua se, <u>në cilësinë e Nëpunësit Autorizues (NA), nuk është drejtuesi i institucionit z.B.X, por zj.V.S me detyrë përgjegjës sektori në sektorin e menaxhimit të akteve dhe laboratorit</u>, sipas shkresave të Ministrisë së Drejtësisë nr.5083prot datë 22.09.2017 dhe nga Ministria e Financave nr.12396/1 prot datë 19.09.2017 me lëndë “Mbi caktimin e Nëpunësit Autorizues të Përkohshëm për IML” sipas rrethanave faktike dhe juridike, si më poshtë vijon:</p> <p>-Institutit i Mjekësisë Ligjore, është institucion në varësi të Ministrit të Drejtësisë, i cili me fillimin e efekteve juridike të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, është përfshirë në skemën e administrimit të shërbimit civil.</p> <p>-Nga auditimi, u konstatua se, <u>B.X</u> gëzon statusin e nëpunësit civil, pasi ka filluar marrëdhënien e punës në këtë institucion, me aktin administrative nr.5762/1 datë 26.11.2013, të ministrit , në pozicionin “Drejtor i Institutit të Mjekësisë ligjore” të cilin e ka mbajtur deri më datë 20.06.2017, deri në daljen e aktit administrative nga ish-Ministri i Drejtësisë me shkresë nr.4052/3 datë 20.06.2017 “Njoftim mbi fillimin e ecurisë disiplinore” e shoqëruar me vendimin përfundimtar nr.4052/8</p>



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN E MJEKËSISË LIGJORE”

datë 28.06.2017 “Për marrjen e masës disiplinore “largim nga shërbimi civil” për z.B.X.”

Për sa më sipër, Z.X e ka ankimuar këtë vendim, duke rifituar vendin e punës dhe rikthimi në detyrë në bazë të vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë nr.3462 datë 13.09.2017, me ekzekutimi të përkohshëm, ka marrë formë të prerë, deri në momentin e vendimit të Gjykatës së Apelit Administrative (është në process ankimimi nga MD).

-Momentalisht, këtë detyrë e ushtron zj.V.S me detyrë përgjegjës sektori në sektorin e menaxhimit të akteve dhe laboratorit, në bazë të shkresave të sipër cituara.

-Në bazë të “Rregullores për organizimin dhe funksionimin e Institutit të Mjekësisë Ligjore” neni 60, janë të përcaktuara detyrimet ligjore të pozicionit të Drejtorit të IML, specifikisht, ky nen përcakton se:

“Drejtori i I.M.L-së është Titullari i Institutit të Mjekësisë Ligjore.

Ai drejton dhe kontrollon veprimtarinë në sistemin e përgjithshëm të ekspertimit mjeko-ligjor, sipas kompetencave të parashikuara në këtë Rregullore.

Drejtori ka të drejtën dhe autoritetin të përfaqësojë I.M.L-në marrëdhënie me të tretët.

Drejtori i I.M.L-së mban përgjegjësi për ligjshmërinë e veprimeve të tij dhe stafit gjatë kryerjes së detyrës dhe kur nuk është i bindur për ligjshmërinë e urdhërave dhe vendimeve që zbaton duhet të informojë menjëherë organet eprorë. Ai nuk është i detyruar të zbatojë një urdhër të paligjshëm.

Drejtori miraton planet e punës të sektorëve në varësi të tij dhe paraqet për miratim në Ministrinë e Drejtësisë planet e punës tremujore dhe vjetore.

Në zbatim të kompetencave të tij, për zbatimin e detyrave nga vartësit, Drejtori nxjerr Urdhëra dhe Udhëzime, të cilat janë të detyrueshme për zbatim nga të gjitha strukturat e I.M.L-së.

Kërkon dhe kontrollon nga të gjithë ekspertët e I.M.L-së, personelin teknik e administrative kryerjen e detyrës me profesionalizëm e korrektësi dhe mbikqyr zbatimin e akteve ligjore e nënligjore në fuqi.”

Grupi i audituesve, vlerëson se, qartësisht disa prej funksioneve të Drejtorit të IML, kufizohen për shkak –pasojë të mospasjes së cilësisë së pozicionit të Nëpunësit Autorizues (NA), kjo në kundërshtim të ligjit nr.9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar neni 19, ligji nr.10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar neni 12, për rrjedhojë dhe ushtrimin e kompetencave në fushën e prokurimeve publike në zbatim të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 56 (titullari i autoritetit kontraktor ose zyrtari i autorizuar).

Si përfundim, grupi i auditimit, vlerëson se ka vonesë të zgjatur në lidhje me miratimin e nëpunësit autorizues (NA) nga Ministria e Drejtësisë në koordinim me Ministrinë e Financave, pasi sipas situatës së mësipërme ky vendim është marrë i mirëqënë dhe si rrjedhojë me ardhjen në detyrë të z.B.X (Drejtor IML) duhet që t’i kalonin dhe detyrat e NA që janë të përcaktuara në bazë të ligjit nr.9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar neni 19, ligji nr.10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar neni 12, për rrjedhojë dhe ushtrimin e kompetencave në fushën e prokurimeve publike në zbatim të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 56 (titullari i autoritetit kontraktor ose zyrtari i autorizuar).



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN E MJEKËSISË LIGJORE”

	<p>Gjithashtu, nga auditimi rezulton se nga Ministria e Drejtësisë, nuk është bërë ende një kërkesë pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për ndryshimin e Nëpunësit Autorizues të Përkohshëm, ndonëse nga IML me shkresat nr1616 prot datë 21.09.2018 dhe nr.1855 prot datë 09.03.2019, është kërkuar ndryshimi respektiv për caktimin e titullarit të institucionit në pozicionin e nëpunësit autorizues.(Materiali i pikës III, është pjesë e materialit dhe të Ministrisë së Drejtësisë)</p>
Kriteri:	<p>Ligji nr.9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar neni 19, ligji nr.10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar neni 12, për rrjedhojë dhe ushtrimin e kompetencave në fushën e prokurimeve publike në zbatim të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 56 (titullari i autoritetit kontraktor ose zyrtari i autorizuar).</p>
Ndikimi/Efekti:	<p>Pozicioni dhe realizimi i disa prej funksioneve të Drejtorit të IML, kufizohen për shkak –pasojë të mospasjes së cilësisë së pozicionit të Nëpunësit Autorizues (NA), kjo në kundërshtim të ligjit nr.9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar neni 19, ligji nr.10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar neni 12, për rrjedhojë dhe ushtrimin e kompetencave në fushën e prokurimeve publike në zbatim të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 56 (titullari i autoritetit kontraktor ose zyrtari i autorizuar).</p>
Shkaku:	<p>Vonesë të zgjatur në lidhje me miratimin e nëpunësit autorizues (NA) nga Ministria e Drejtësisë në koordinim me Ministrinë e Financave, pasi sipas situatës së mësipërme ky vendim është marrë i mirëqënë dhe si rrjedhojë me ardhjen në detyrë të z.B.X (Drejtor IML) duhet që t’i kalonin dhe detyrat e NA që janë të përcaktuara në bazë të ligjit</p>
Rëndësia:	<p>E lartë</p>

Titulli i Gjetjes nr. 3:	<p>Mbi problematikat e evidentuara në procedurat e Blerjeve me vlerë të vogël</p>
Situata:	<p>Nga auditimi me zgjedhje i procedurave të prokurimit për periudhën Janar-Tetor 2019, rezultoi se, në një numër të konsiderueshëm rastesh, nga njësia e prokurimit nuk janë respektuar përcaktimet e bëra në kuadrin ligjor të prokurimeve publike, kryesisht të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, konkretisht në administrimin e dokumentacionit të përcaktuar që duhet të ketë një procedurë prokurimi, mungesën e llogaritjes së fondit limit, etj. Konstatohet se në të gjitha procedurat nuk administrohet proces-verbali për llogaritjen e fondit limit. Në të gjitha praktikat e blerjeve me vlerë të vogël përgjatë vitit 2019 për llogaritja e fondit limit është bërë bazuar çmimeve të blerjeve të vitit 2018, bazuar në tabelën përkatëse të pa firmosur nga komisioni i blerjeve të vogla për vitin 2018. Mungojnë specifikimet teknike dhe kriteret e kualifikimit rast pas rasti në kundërshtim me përcaktimet e bëra në nenin 23 të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, pikën 5/a-c të nenit 27, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar. Në</p>



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN E MJEKËSISË LIGJORE”

	<p>prokurimet me vlerë të vogël është llogaritur për cdo rast fondi limit para daljes së urdhër prokurimit, por pasqyrat e llogaritjes nuk janë administruar në dokumentacionin prokurues. Për mallrat e prokuruar me blerje të vogla nuk është përpiluar procesverbali i marrjes në dorëzim para hyrjes në magazinë.</p> <p>Gjithashtu në dosjet përkatëse të audituara u evidentuan mangësi në dokumentacion si, mungesë e Deklaratave të Konfliktit të Interesit të firmosura nga anëtarët e KVO, e faturave të akomodimit në hotel dhe gjithashtu shkresave mbi aktivitetin që do ka qenë i pranishëm përfaqësuesi nga Instituti i Mjekësisë Ligjore, etj.</p>
Kriteri:	<p>-Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, -VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 40 (Procedura e prokurimit me vlerë të vogël). -Ligji nr.9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar neni 19, ligji nr.10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar</p>
Ndikimi/Efekti:	Efekte negative në menaxhimin e fondeve publike me efektivitet, efikasitet dhe ekonomicitet .
Shkaku:	Mangësi e strukturave përgjegjëse
Rëndësia:	E mesme

Drejtimi 3: Mbi zbatimin e procedurave dhe vlerësimi i auditimit të kryer nga struktura e Auditimit të Brendshëm e Ministrisë së Drejtësisë në IML:

Drejtorja e Auditimit të Brendshëm pranë Ministrisë së Drejtësisë gjatë periudhës Janar-Tetor 2019, ka zhvilluar dy angazhime auditimi pranë Institutit të Mjekësisë Ligjore.

1. Në programin e angazhimit nr.4727/1 prot. datë 24.06.2019, në subjektin **Instituti i Mjekësisë Ligjore** me lloj auditimi “auditim i shërbimit të sigurisë” për periudhën 01.01.2017-30.06.2019 dhe afat auditimi 17.06.2019-12.07.2019 pra 25 ditë kalendarike. Drejtimet e auditimit përfshin fushëveprimin e subjektit të audituar. Ky auditim nuk është zhvilluar pranë këtij institucioni si rrjedhojë e problematikave të shfaqura midis subjektit të audituar dhe grupit të auditimit, për të cilat është informuar zyrtarisht në vijueshmëri Titullari i institucioni.
2. Në programin e angazhimit nr.7155/1 prot. datë 21.10.2019, në subjektin **Instituti i Mjekësisë Ligjore** me lloj auditimi auditim i kombinuar “I sigurisë, përputhshmërisë, financiar dhe performancës” periudhë auditimi (ska) dhe afat auditimi 21.10.2019-25.10.2019 pra 5 ditë kalendarike. Drejtimet e auditimit përfshin sistemin e prokurimeve. Ky auditim megjithëse ka tejkaluar afatet, sipas të dhënave të marra nga auditimi paralel i ushtruar pranë Ministrisë së Drejtësisë ende nuk është miratuar nga Titullari i institucionit dhe të ketë marrë formë zyrtare.

Ndodhur në këto rrethana, nuk disponohet një material auditimi i cili do i mundësonte grupit të auditimit vlerësimin e zbatimit të procedurave të auditimit nga DAB apo ndjekjen e masave të rekomanduara nga subjekti i audituar, (IML). Një vlerësim më i hollësishëm mbi gjendjen në të cilën ndodhet struktura e auditimit të brendshëm dhe mangësitë procedurale, janë trajtuar më hollësisht në materialin auditues të mbajtur në auditimin e zhvilluar paralelisht në Ministrinë e Drejtësisë.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN E MJEKËSISË LIGJORE”

❖ Të tjera:

Në KLSH është paraqitur ankesa me nr. 953 prot, datë 21.11.2019, në të cilën ngrihen problematika të cilat lidhen kryesisht me menaxhimin financiar të institucionit dhe procesin e rekrutimit të personelit, por jo vetëm. Meqenëse çështjet e ngritura i përkasin kryesisht periudhave jashtë auditimit, si dhe nevojës për një hetim administrativ të detajuar dhe shumëplanësh, Kontrolli i Lartë i Shtetit, vlerëson të dërgojë pranë Drejtorisë së Inspektimit Financiar në MFE, një kopje të ankesës së bashku me Raportin Përfundimtar të Auditimit të mbajtur, për të trajtuar me objektivitet dhe profesionalizëm të gjitha çështjet e ngritura në këtë ankesë.

V- KONKLUZIONE

Nga auditimi mbi veprimtarinë e IML u konstatuan mangësi dhe të meta në disa nga fushat e audituara ku përmendim: Nga titullari i AK, për periudhën 01.01.2019 deri në 30.10.2019, nuk është caktuar personi përgjegjës për prokurimin, kjo në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014. Staf i përgjegjës për zhvillimin e procedurave të prokurimit nuk disponon trajnimet e nevojshme për pasojë janë evidentuar paqartësi në hartimin e kriterëve të veçanta për kualifikim dhe specifikimeve teknike. Nëpunësi Zbatues, është aktivizuar në disa struktura të prokurimeve publike (në hartimin e fondit limit; në njësinë e prokurimit dhe në ekzekutimin e kontratës), veprime të cilat bien ndesh me dispozitat ligjore në fuqi. Në të gjitha praktikat e blerjeve me vlerë të vogël përgjatë vitit 2019 përllogaritja e fondit limit është bërë bazuar çmimeve të blerjeve të vitit 2018, bazuar në tabelën përkatëse të pa firmosur nga komisioni i blerjeve të vogla, mungojnë specifikimet teknike dhe kriteret e kualifikimit, për cdo rast fondi limit është llogaritur para daljes së urdhër prokurimit etj. Institucioni ende rezulton me problematikë të pazgjidhur mbi caktimin e Titullarit si Nëpunës Autorizues.

A. OPINIONI I AUDITIMIT

-Nga auditimi mbi përputhshmërinë e veprimtarisë së Institutit të Mjekësisë Ligjore, sa i takon shkallës së zbatueshmërisë së rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat ky institucion realizon misionin e tij, (kriteret e auditimit të përputhshmërisë), janë konstatuar disa mangësi dhe parregullsi. Gjatë auditimit në terren janë të marrë të dhëna të mjaftueshme të cilat mundësojnë dhënien e opinionit.

Opinion i kualifikuar mbi përputhshmërinë

Sipas opinionit të KLSH-së, nga auditimi i përputhshmërisë¹, i mbështetur në standardet INTOSAI dhe në Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë së KLSH-së, i kryer në subjektin Institutit të Mjekësisë Ligjore, rezultuan devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi

¹ Mbështetur mbi ligjin nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH-së”

² Një opinion i kualifikuar shprehet kur efekti ose efektet e mundshme të një çështjeje, nuk janë aq materiale sa të justifikojnë dhënien e opinionit të kundërt ose një refuzim të opinionit

³ ISSAI 4000 – Udhërrëfytyesi i Auditimit të Përputhshmërisë



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN E MJEKËSISË LIGJORE”

(kriteret), të cilat në gjykimin profesional të audituesit shtetëror të pavarur janë materiale por jo të përhapura, efektet e të cilave justifikojnë dhënien e *një opinionit të kualifikuar të përputhshmërisë*².

Baza për opinionin e kualifikuar (ISSAI 4000³)

Ne e kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik (ISSAIs), ISSAI-n 4000 ”Standardi i Auditimit të Përputhshmërisë”. Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, mbështetur në ISSAI-n 10- Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30- Kodi Etik. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura, përfshirë këtu edhe Kodin e Etikës së KLSH-së. Auditimi ynë përfshin kryerjen e procedurave me qëllim marrjen e evidencave të auditimit, mbi ligjshmërinë dhe rregullshmërinë e veprimtarisë të ushtruar nga subjekti i audituar. Procedurat janë përzgjedhur mbështetur mbi gjykimin profesional të audituesit, duke marrë në konsideratë vlerësimin e riskut dhe materialitetit për subjektin e audituar.

Nga evidencat e marra për veprimtarinë e IML-së gjatë periudhës Janar-Tetor 2019, rezultoi se:

Nga auditimi mbi veprimtarinë e IML u konstatuan mangësi dhe të meta në disa nga fushat e audituara ku përmendim: Institucioni ende rezulton me problematikë të pazgjidhur mbi caktimin e Titullarit si Nëpunës Autorizues. Aktualisht në cilësinë e Nëpunësit Autorizues (NA), nuk është drejtuesi i institucionit z. B.X, por zj. V.S me detyrë *përgjegjës sektori në sektorin e menaxhimit të akteve dhe laboratorit*, sipas shkresave të Ministrisë së Drejtësisë nr. 5083 prot, datë 22.09.2017 dhe nga Ministria e Financave nr. 12396/1 prot datë 19.09.2017 me lëndë “*Mbi caktimin e Nëpunësit Autorizues të Përkohshëm për IML*”. Megjithëse nga IML me shkresat nr. 1616 prot datë 21.09.2018 dhe nr. 1855 prot, datë 09.03.2019, është kërkuar ndryshimi respektiv për caktimin e titullarit të institucionit, pra z. B.X në pozicionin e nëpunësit autorizues, nga ana e Ministrisë së Drejtësisë kemi ende zvarritje të problematikës dhe moszgjidhje në kohë të saj.

Në të gjitha praktikatat e blerjeve me vlerë të vogël përgjatë vitit 2019 përlogaritja e fondit limit është bërë bazuar çmimeve të blerjeve të vitit 2018, bazuar në tabelën përkatëse të pa firmosur nga komisioni i blerjeve të vogla për vitin 2018, mungojnë specifikimet teknike dhe kriteret e kualifikimit, për çdo rast fondi limit është llogaritur para daljes së urdhër prokurimit etj. Nëpunësi Zbatues, është aktivizuar në disa struktura të prokurimeve publike (në hartimin e fondit limit; në njësinë e prokurimit dhe në ekzekutimin e kontratës), veprime të cilat bien ndesh me dispozitat ligjore në fuqi. Evidentohet se, numri i personelit të administratës në strukturë paraqitet tejet i ulët referuar ngarkesës institucionale. Staf i përgjegjës për zhvillimin e procedurave të prokurimit nuk disponon trajnimet e nevojshme për pasojë janë evidentuar paqartësi në hartimin e kriterëve të veçanta për kualifikim dhe specifikimeve teknike.

Ne arritëm në konkluzionin se, problematikat e konstatuara kanë ekspozuar institucionin drejt risqeve për përmbushjen e detyrimeve, në zbatim të ligjshmërisë dhe rregullshmërisë së veprimtarisë së tij .

Për përmirësimin e gjendjes rekomandojmë marrjen e masave si *më poshtë*:



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN E MJEKËSISË LIGJORE”

B. MASA ORGANIZATIVE

1- Gjetje nga auditimi: Nga auditimi në Institutin e Mjekësisë Ligjore, në bazë të dokumentacionit të vënë në dispozicion të realizimit të procedurave dhe ekzekutimit të prokurimeve publike, sipas ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 56 (titullari i autoritetit kontraktor ose zyrtari i autorizuar), rezultoi se, në cilësinë e Nëpunësit Autorizues (NA), nuk është drejtuesi i institucionit z. B.X, por zj. V.S me detyrë përgjegjës sektori në sektorin e menaxhimit të akteve dhe laboratorit, sipas shkresave të Ministrisë së Drejtësisë nr. 5083 prot, datë 22.09.2017 dhe nga Ministria e Financave nr. 12396/1 prot datë 19.09.2017 me lëndë “Mbi caktimin e Nëpunësit Autorizues të Përkohshëm për IML” sipas rrethanave faktike dhe juridike, si më poshtë vijon:

-Institutit i Mjekësisë Ligjore, është institucion në varësi të Ministrit të Drejtësisë, i cili me fillimin e efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, është përfshirë në skemën e administrimit të shërbimit civil.

-Nga auditimi, u konstatua se, B.X gëzon statusin e nëpunësit civil, pasi ka filluar marrëdhënien e punës në këtë institucion, me aktin administrative nr. 5762/1 datë 26.11.2013, të ministrit, në pozicionin “Drejtor i Institutit të Mjekësisë ligjore” të cilin e ka mbajtur deri më datë 20.06.2017, deri në daljen e aktit administrative nga ish-Ministri i Drejtësisë me shkresë nr.4052/3 datë 20.06.2017 “Njoftim mbi fillimin e ecurisë disiplinore” e shoqëruar me vendimin përfundimtar nr. 4052/8 datë 28.06.2017 “Për marrjen e masës disiplinore “largim nga shërbimi civil” për z. B.X.”.

Për sa më sipër, Z. X e ka ankimuar këtë vendim, duke rifituar vendin e punës dhe rikthimi në detyrë në bazë të vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë nr. 3462 datë 13.09.2017, me ekzekutim të përkohshëm, ka marrë formë të prerë, deri në momentin e vendimit të Gjykatës së Apelit Administrative (është në proces ankimimi nga MD).

-Momentalisht, këtë detyrë e ushtron zj. V.S me detyrë përgjegjës sektori në sektorin e menaxhimit të akteve dhe laboratorit, në bazë të shkresave të sipër cituara.

-Në bazë të “Rregullores për organizimin dhe funksionimin e Institutit të Mjekësisë Ligjore” neni 60, janë të përcaktuara detyrimet ligjore të pozicionit të Drejtorit të IML.

Nga auditimi vlerësohet se, qartësisht disa prej funksioneve të Drejtorit të IML, kufizohen për shkak-pasojë të mospasjes së cilësisë së pozicionit të Nëpunësit Autorizues (NA), kjo në kundërshtim të ligjit nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 19, ligji nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, neni 12, për rrjedhojë dhe ushtrimin e kompetencave në fushën e prokurimeve publike në zbatim të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 56 i tij.

Evidentohet, vonesë e zgjatur në lidhje me miratimin e nëpunësit autorizues (NA) nga Ministria e Drejtësisë në koordinim me Ministrinë e Financave, pasi sipas situatës së mësipërme ky vendim është marrë i mirëqenë dhe si rrjedhojë me ardhjen në detyrë të z.B.X (Drejtor IML) duhet që t’i kalonin dhe detyrat e NA që janë të përcaktuara në bazë të ligjit nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar neni 19, ligji nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar neni 12, për rrjedhojë dhe ushtrimin e kompetencave në fushën e prokurimeve publike në zbatim të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 56 (titullari i autoritetit kontraktor ose zyrtari i autorizuar).



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN E MJEKËSISË LIGJORE”

Gjithashtu, nga auditimi paralel në Ministrinë e Drejtësisë rezultoi se, prej saj nuk është bërë ende kërkesë pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për ndryshimin e Nëpunësit Autorizues të Përkohshëm, ndonëse nga IML me shkresat nr. 1616 prot, datë 21.09.2018 dhe nr. 1855 prot, datë 09.03.2019, është kërkuar ndryshimi respektiv për caktimin e titullarit të institucionit në pozicionin e nëpunësit autorizues. *Trajtuar më hollësisht në faqet nr 12-32 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

1.1 Rekomandimi: Nga Ministria e Drejtësisë, në bashkëpunim me Departamentin e Administratës Publike dhe Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë të merren masa për emërimin dhe realizimin e ndryshimit të Nëpunësit Autorizues të Përkohshëm, referuar shkresës së IML me nr. 1616 prot, datë 21.09.2018 dhe nr. 1855 prot datë 09.03.2019, me të cilat është kërkuar ndryshimi respektiv, për caktimin e titullarit të institucionit z. B.X në pozicionin e nëpunësit autorizues.

Menjëherë

2- Gjetje nga auditimi: -Nga auditimi i të gjitha objekteve tenderuese kryesisht për mallra/punë për shkak të specifikës së detyrës funksionale të institucionit të IML, konkretisht procedurat me objekt;

-“Blerje reagentësh dhe materiale laboratorike” me fond limit 12,508,333 lekë pa tvsh;

-“Blerje pajisje për autopsinë”, me fond limit 4,183,333 lekë pa tvsh.

-“Rikonstruksioni i çatisë dhe ambienteve të brendshme IML”, me fond limit 4,099,712 lekë pa tvsh.

Rezultoi se, IML si Autoritet Kontraktor, ka numër të kufizuar të administratës me burime njerëzore, për shkak të strukturës me numër të vogël, të cilët rezultuan të pa trajnuar në mënyrë periodike pranë Agjencisë së Prokurimeve Publike (APP), për pasojë janë evidentuar paqartësi në hartimin e kriterëve të veçanta për kualifikim dhe specifikimeve teknike (në këto struktura janë angazhuar mjekë specialist të fushës), të cilët duhet t’i paraqisnin vendosjen e tyre në mënyrë të hollësishme duke e argumentuar, duke mbajtur një procesverbal, në mbështetje të ligjit nr. 9646 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”i ndryshuar, neni 27 (kontrata e mallrave), neni 26 (kontrata pune) neni 61 (hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit).

-Nga auditimi u konstatua se, nga titullari i AK, për periudhën 01.01.2019 deri në 30.10.2019, nuk është caktuar personi përgjegjës për prokurimin, kjo në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”i ndryshuar, neni 57, i ndryshuar me VKM nr. 797, datë 29.12.2017 “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik.”

-Gjithashtu, rezultoi se, Nëpunësi Zbatues, është aktivizuar në disa struktura të prokurimeve publike (në hartimin e fondit limit; në njësinë e prokurimit dhe në ekzekutimin e kontratës), veprime të cilat bien ndesh me ligjin nr. 9646 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”i ndryshuar, ligjit nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe ligji nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar. *Trajtuar më hollësisht në faqet nr 12-32 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

2.1 Rekomandimi: Nga Autoriteti Kontraktor i Institutit të Mjekësisë Ligjore, të merren masa, për të analizuar me kujdes të gjitha veprimet nga struktura prokurore, për vendosjen e kriterëve dhe kërkesave kualifikuese, sa më të qarta dhe jodiskrimuese, për të mundësuar



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN E MJEKËSISË LIGJORE”

përfshirjen në garë të një numri sa më të madh ofertuesish dhe garantimin e efektivitetit, efikasitetit dhe ekonomicitetit të fondeve publike.

Menjëherë dhe në vijimësi

2.2 Rekomandimi: Instituti i Mjekësisë Ligjore, në bashkëpunim me APP, e cila në mënyrë të vazhdueshme bashkëpunon me Shkollën Shqiptare të Administratës Publike për organizimin e trajnimeve për punonjësit e institucioneve qendrore të angazhuar me procedurat e prokurimit publik, të realizoj trajnimet e nevojshme për punonjësit e saj, me qëllim forcimin e kapacitetit administrative në këtë fushë.

Menjëherë dhe në vijimësi

3- Gjetje nga auditimi: Nga auditimi me zgjedhje i procedurave të prokurimit për periudhën Janar-Tetor 2019, rezultoi se, në një numër të konsiderueshëm rastesh, nga njësia e prokurimit nuk janë respektuar përcaktimet e bëra në kuadrin ligjor të prokurimeve publike, kryesisht të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, konkretisht në administrimin e dokumentacionit të përcaktuar që duhet të ketë një procedurë prokurimi, mungesën e llogaritjes së fondit limit, etj.

Pavarësisht se, numri i administratës është tejet i ulët sa i përket burimeve njerëzore, çka kërkon kujdesin e duhur nga instancat përkatëse në këtë drejtim, evidentohen mangësi, ku përmendim: Thuajse në të gjitha procedurat nuk administrohet proces-verbali për llogaritjen e fondit limit. Në praktikën e blerjeve me vlerë të vogël përgjatë vitit 2019 përllogaritja e fondit limit është bërë bazuar çmimeve të blerjeve të vitit 2018, bazuar në tabelën përkatëse të pa firmosur nga komisioni i blerjeve të vogla për vitin 2018. Mungojnë specifikimet teknike dhe kriteret e kualifikimit rast pas rasti në kundërshtim me përcaktimet e bëra në nenin 23 të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, pikën 5/a-c të nenit 27, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar. Në prokurimet me vlerë të vogël është llogaritur për çdo rast fondi limit para daljes së urdhër prokurimit, por pasqyrat e llogaritjes nuk janë administruar në dokumentacionin prokurues. Për mallrat e prokuruar si blerje të vogla nuk është përpiluar procesverbali i marrjes në dorëzim para hyrjes në magazinë.

Gjithashtu në dosjet përkatëse të audituara u evidentuan mangësi në dokumentacion si, mungesë e Deklaratave të Konfliktit të Interesit të firmosura nga anëtarët e KVO, e faturave të akomodimit në hotel dhe gjithashtu shkresave mbi aktivitetin që do ka qenë i pranishëm përfaqësuesi nga Instituti i Mjekësisë Ligjore, etj. *Trajtuar më hollësisht në faqet nr 12-32 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

3.1 Rekomandimi: Nga Instituti i Mjekësisë Ligjore, të merren masat e nevojshme administrative për mirëfunksionimin e procedurave të prokurimit publik, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi. Nga ana e Sektorit të Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse të institucionit të mos kryhet asnjë pagesë e pashoqëruar me dokumentacionin përkatës.

Në vijimësi



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN E
MJEKËSISË LIGJORE”

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT